

INTERVISTA EKSKLUZIVE NE REPORT TV

DJALI I REMZI HOXHES: ILIR KUMBARO E SEFGJINI SHANTAZH BERISHES

"Sali Berisha përgjegjësi kryesor për vrasjen e babait tim, pa ndikim ndërkombëtar nuk zbardhet çështja"

► FAQE 5



[SHQIPTARJA.com]

ÇMIMI 30 LEKË

VITI VI - NR. 288

E DIEL, 04-12-2016

www.shqiptarja.com



INTERVISTA

SABIT BROKAJ: KERCENIMI GREK, TE RINGRIHET USHTRIA

Ish-ministri i Mbrojtjes: Greqia kërkon nënshtrim, lëshimet që u bëri Berisha nga Janullatosi tek falja e detit

► F3

SUPLEMENTI "RILINDASI"

KOSOVA DHE ENVER HOXHA, KEQKUPTIMET HISTORIKE

NGA MEHMET KRAJA



Kolë Shiroka, mjeshtri i madh shkodran i karnavaleve

NGA XHAHID BUSHATI

► F 15-22

PRAPASKENAT

► F 8-9

Misioni i panjohur në Moskë i të besuarës së Berishës në prill të 2012

Edit Harxhi loboi për forcimin e marrëdhënieve me Rusinë



LAMTUMIRE KOLEG!

► F 12-13

Ndahet nga jeta gazetari dhe analisti i njohur Andrea Stefani

Shuhet një nga zërat më të fuqishëm të medias shqiptare



Dokumenti

SA DO TE PAGUHEN POLICET PER ÇDO ORE SHTESE

Zbardhet përlogaritja e tarifës për një punonjës policie sipas gradës për një orë punë. Skema e re të funksionimit të orareve të punës, lejeve dhe pushimeve vjetore apo ditore

► FAQE 4

Ministrja Kodheli i përgjigjet Kamenos: Iku koha e satrapëve

Vangjel Dule justifikon deklaratat provokuese të deputetes Theoharous



Ministri i Mbrojtjes së Greqisë, Panos Kamenos

Ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, i është përgjigjur ashpër kërcënimeve të homologut të saj grek, Panos Kamenos, i cili dy ditë më parë, paralajmëroi Shqipërinë, por edhe Turqinë, që të mos guxojnë të sfidojnë Greqinë me deklaratat provokuese. Në një postim në rrjetin social Facebook, ministrja Kodheli ka shkruar se kanë ikur kohët e satrapëve, duke i përgjigjur kësaj kërcënimeve të Panos Kamenos. Zonja Kodheli shkruan gjithashtu se e ka të vështirë që të kuptojë se pse ndonjë politikan në Ballkan vesh uniformë ushtarake dhe përpigjet të ngrejë fantazma të së shkuarës. "NATO u

krijua për të bashkuar vendet demokratike të hemisferës veriore përballë çdo rreziku totalitar. Por sot e kam të vështirë të kuptoj pse ndonjë politikan në Ballkan

vesh uniformë ushtarake dhe përpigjet të ngrejë fantazma të së shkuarës. Kanë ikur kohët e satrapëve. Give peace a chance", shkruan Kodheli. Deklaratat e Kamenos pasojnë

deklaratat e Ministrisë të Jashtëm grek, i cili disa ditë më parë, tha se Athina është më e fortë se Shqipëria si në anën ekonomike, por edhe ushtarake. Ndërkaq, kryemi-

nistri Edi Rama ka pohuar se ky tension është artificiale, por Rama ka pohuar se ka ikur koha e Greqisë së pasur, e cila i tregonte arat fqinjët të varfër.

KËRCËNIMI

Ministri i Mbrojtjes së Greqisë, Panos Kamenos ka artikuluar disa deklarata kërcënuese në adresë të Tiranës dhe Ankar-



Kodheli

"NATO u krijua për të bashkuar vendet demokratike të hemisferës veriore përballë çdo rreziku totalitar. Sot e kam të vështirë të kuptoj pse ndonjë politikan në Ballkan vesh uniformë ushtarake dhe përpigjet të ngrejë fantazma të së shkuarës. Kanë ikur kohët e satrapëve".



Kamenos

"Dua të dërgoj një mesazh për të gjithë ata që guxojnë të sfidojnë traktatet ndërkombëtare me deklarata provokuese. Deklaratat e fundit nga Rama na sjellin përsëri në kujtesën tonë se ata për të cilët ai flet ishin bashkëpunëtorë të nazistëve. Ne nuk do të pranojmë sfida të tilla".

NGJELA:

"Kamenos ka marrë zemër nga Saliu"

Avokat Spartak Ngjela shkruan se ministri i Mbrojtjes greke dhe deputetja greke e Qipros mund të ketë marrë zemër nga ish-kryeministri, Sali Berisha. "Ministri grek na bëri për të qeshur. Na ishte veshur edhe ushtarak. Por na gajasi një tjetër injorance që e paskësh sjellë në Shqipëri Vangjel Dulja. Kanë marrë zemër siç duket edhe nga Saliu. Të shpëtojme detyrimin për gjenocidin çam; të shpëtojme detyrimin për pronat çame. Të shpëtojme nga guximi që po marrin shqiptarët për të folur shqip në Igumenicë, Prevezë e kudo në Epirin puro shqiptar. Dhe, njëherësh, të shpëtojme dhe Sali Berishën, dhe aradhen e tij të korruptuar, nga ndëshkimi në Shqipëri. O mavri me bojë: asgjë nuk bëni dot se jeni në pikë të hallit! Të gjitha detyrimet që iu keni Shqipërisë dhe shqiptarëve, do t'i paguani e do t'i dorëzoni një e nga një", shkruan Ngjela.



DEKLARATAT E FORTA

Himarë, ngrihet flamur grek në avllinë e shtëpisë

Një flamur grek është ngritur mëngjesin e djeshëm në hyrje Himarës, në murin rrethues të një shtëpie. Flamuri është ngritur mëngjesin e djeshëm, ndërsa ky veprim vjen dy ditë pas deklaratave të forta të zyrtarëve grekë ndaj Tiranës zyrtare. Ministri grek i Mbrojtjes, Panos Kamenos, paralajmëroi zyrtarisht Shqipërinë "të mos sfidojë Greqinë" kurse deputetja greke e Qipros, Eleni Theoharous, në zemër të Tiranës, u shpreh ndodhej në mes të Vorio Epirit. Po ashtu, me rastin e Festës Kombëtare në Greqisë, banorët e Dervicianit kanë shpalosur një flamur gjigant në shtatin e Malit të Gjerë. Flamuri është vendosur në tokë dhe duket se ka përmasa të mëdha dhe të dukshme nga rruga kryesore. Ndërkohë në aksin rrugor kombëtar Tepelenë-Gjirokastrë po mëngjesin e djeshëm, sipas një fotoje rezultoi të jenë shkruar me sprajt parulla për "Vorio-Epirin". Ndërsa mbrëmjen e së premtes është djegur flamuri grek në një nga zyrat e organizatës OMONA, në Sarandë. Flamuri i djegur qëndronte mes flamurit shqiptar dhe atij të Bashkimit Evropian.



"STOCHOS"

Mediat greke thirrje për dëbimin e shqiptarëve

Mediat greke, duke u bërë pjesë e gjuhës së ekstremizmit, kanë bërë thirrje për dëbimin e shqiptarëve nga Greqia. E përditshmja "Stochos" është hapur me një kryeartikull ku i bën thirrje autoriteteve greke të dëbojnë të gjithë emigrantët shqiptarët, që sipas shkrim-it janë "kolona e pestë e Turqisë në Greqi". Me anë të një fotomontazhi provokues, "Stochos" e ka përfunduar flamurin tonë kombëtar me atë të Turqisë duke vendosur përballë një ushtar grek të acaruar që i gjuan me plumb. Të gjitha këto reagime ekstremiste kanë nisur pa u mbushur as 24 orë nga deklaratat provokuese të ministrit grek të Mbrojtjes, Panos Kamenos. Në të kaluarën, kur tensioni mes Tiranës dhe Athinës është shtuar, autoritetet greke kanë ndërmarrë fshesa masive, duke dëbuar shqiptarët nga Greqia. Shpeshherë nuk kanë munguar as reprezaljet dhe dhuna ndaj emigrantëve shqiptarë, kryesisht ilegalë. Ndërkaq, vitin e fundit, dy shqiptarë kanë humbur jetën nga torturat në buxhet greke. Në kufi janë kthyer edhe të moshuar, ndërsa kush shkruan për Çështjen Çame rrezikon të shpallet non grata.



IRONIA

Braçe: Kamenos jeton në shekullin e kaluar

Deputeti i Partisë Socialiste, Erjon Braçe ka ironizuar deklaratat e ministrit grek të Mbrojtjes, i cili kishte veshur rrobat ushtarake dhe bënte deklarata force në kufi me Shqipërinë. Braçe ironizon dhe me politikën greke, duke kërkuar që të mos zgjohen nga shekulli i kaluar pasi kanë pasur diktaturat brenda, dhe diktaturën fashiste. Sipas deputetit socialist, udhëheqësit grekë nuk shpëtojnë dot nga ai shekull. Erjon Braçe ka vlerësuar ata që luftuan për t'i çliuar grekët nga junta e tyre, por sipas deputetit, ata burra nuk kanë lidhje me ministrin e sotëm grek të Mbrojtjes. "Qirre Panos Kamenos! Ha ha ha ha ha ha ha ha! Mos i zgjoni këta udhëheqës grekë! Lërimi të jetonjë në shekullin e shkuar, shekullin e tyre! Nuk shpëtojnë dot nga ai shekull! Kanë patur edhe diktaturë fashiste brenda. Respekt për secilin prej atyre që luftoi për t'i çliuar nga junta e tyre, por ishin të tjerë burra ata, s'kanë lidhje me Panon e sotëm", ka theksuar Braçe.





← asë. "Dua të dërgoj një mesazh për të gjithë ata që guxojnë të sfidojnë traktatet ndërkombëtare me deklaratat provokuese. Nga njëra anë kemi Turqinë, e cila me deklaratat e saj të përsëritura po përpiqet të minojë klimën politike. Përgjigja jonë është sipas të drejtës ndërkombëtare, duke mbrojtur sovranitetin kombëtar të vendit. Ndërsa deklaratat e fundit nga Rama na sjellin përsëri në kujtesën tonë se ata për të cilët ai flet ishin bashkëpunëtorë të nazistëve. Ne nuk do të pranojmë sfida të tilla, ne nuk do të pranojmë raporte të tilla, të cilat infektjnë dhe historinë dhe të drejtën ndërkombëtare", tha ai.

DULE JUSTIFIKON THEOHAROUS

Kreu i PBDNJ, Vangjel Duke, i ka justifikuar duket i quajtur politike deklaratat provokuese dhe fyese të deputetes greke të Qipros, Eleni Theoharous. Në një takim të organizuar nga Dule në Tiranë, Theoharous u shpreh se ndodhjet në mes të greqizmit të Vorio-Epirit. Ajo shtoi se Shqipëria ishte vegël e Turqisë, ndërsa bëri thirrje për rezistencë greke. Ndërkaq, kreu i PBDNJ, Vangjel Duke u shpreh dje se këto deklaratat janë politike dhe se nuk ndikojnë në miqësinë mes dy vendeve. "Më shumë se kurrë, kur ka deklaratat që mund të kalohen vijat tradicionale, dëshmohet se tradicia mes dy popujve është e pandikuar nga politikanët. Nuk ka popuj si ne, me fije kaq të shumta miqësie. Ky është angazhimi im dhe i PBDNJ-së për forcim marrëdhëniesh", tha Dule.

AKUZAT

Vangjel Duke, u shpreh dje se forca e tij politike, kohët e fundit, është përballur me sulme të paprecedent nga kreu i PS-së, ndërsa përjashtoi një koalicion të mundshëm me këtë forcë politike. Ai akuzoi kryeministrin Edi Rama se po tenton që të zbeh rolin e Greqisë, duke shtuar se ajo është avokate e Shqipërisë për në NATO dhe BE. "Në BE nuk veprohet në mënyrë të njëanshme. Uroj të vendim më dobi të vendit tonë, edhe pse s'i kemi kryer detyrat e shtëpisë në nivelin e duhur. Rilindja reflekton qëndrimet individuale të Ramës", tha ai.

Ish-ministri i Mbrojtjes, Sabit Brokaj, duke komentuar kërcënimet e përsëritura të ministrit të Mbrojtjes së Greqisë, Panos Kamenos, pohon se shtetarët shqiptarë duhet të ringrenë ushtrinë dhe sistemin mbrojtës. Sipas tij, gjatë 25 viteve, formula e bazë e ekzistencës së shtetit, që është armatosja dhe sistemi mbrojtës, është harruar dhe sabotuar. Brokaj thekson se kërcënime të tilla vijnë edhe për shkak se Shqipëria nuk ka asnjë kapacitet mbrojtës përveç NATO-s. Ish-ministri i Mbrojtjes mendon se Greqia është habitur për ngritjen në mënyrë korrekte nga kryeministri Edi Rama të problemeve që duhen zgjidhur. Sipas tij, me anë të kërcënimeve, Athina kërkon rikthimin e politikës së servilizimit dhe të nënshtrimit të shtetarëve dhe politikës shqiptare. Brokaj ka kujtuar këtu lëshimet që Sali Berisha u bëri grekëve për interesa të pushtetit që nga prurja e Janollatosit deti tek shitja e detit. Sipas tij, Berisha në këtë drejtim është më keq se Esat Pashë Toptani.

-Z. Brokaj, ka një tensionim marrëdhëniesh dhe retorikë helmuese mes Tiranës dhe Athinës. A duhet të merren seriozisht gjuha ushtarake dhe kërcënimet e përsëritura të ministrit të Mbrojtjes së Greqisë, Panos Kamenos, në adresë të Shqipërisë?

Kërcënimet e ministrit të Mbrojtjes së Greqisë, në situatën aktuale, nuk duhen marrë parasysh. Së pari ne jemi anëtarë të NATO-s, ndërsa Greqia është në një situatë të vështirë. Por, thirrjet e Kamenos dhe të ministrit tjetër, tregojnë një gjë: Që përveç shqiptarëve, të gjithë shtetarët e dinë, që politika mund të ndryshojë me ditë, ndërsa sistemi i mbrojtjes duhet të jetë i përhershëm. Të gjithë shtetarët e Shqipërisë, pas viteve '90, formulën bazë të ekzistencës së shtetit e kanë neglizhuar, e kanë harruar apo e kanë sabotuar. Ministri i Mbrojtjes së Greqisë flet ashtu, flet më atë gjuhë, për të trembur shqiptarët për momentin, në mënyrë që të vijojë politika servile e shqiptarëve dhe ajo e nënshtrimit ndaj grekëve. Atyre u është dukur çudi dhe është e papajftueshme për të ta, që një kryeministër i Shqipërisë së varfër të flasë me dinjitet, qartë dhe në mënyrë më korrekte për problemet që duhen zgjidhur. Pozicioni plotësisht korrekt i Edi Ramës lidhur me pohimet me Greqinë, atyre u është dukur një çudi e madhe për arsye se, kryeministrat, presidentët dhe politikanët e Shqipërisë, në këto 25 vjet, kanë paraqitur portretin më servil, të nënshtruar dhe të neveritshëm të Shqipërisë. Ndaj dhe ato habiten dhe ministri merr këto poza të luftëtarit, në mënyrë që politika shqiptare të shkojë aty ku ishte, domethënë të bëhet po servile dhe e nënshtruar. Thirrjet e tij kanë aktualisht këtë funksion. Por, unë i vlerësoj pozitivisht thirrjet e tij, në mënyrë që, shtetarët dhe politikanët shqiptarë të vënë gishtin kokës dhe të mos e shkatërronin ushtrinë nën emrin e "reformës". Shqipëria nuk ka asnjë kapacitet mbrojtës. Shqipëria e bazon ekzistencën thjeshtë mbi ekzistencën e NATO-s.

SABIT BROKAJ

'Të ringrihet ushtria, prapaskenat e kërcënimit grek'

"Greqia kërkon nënshtrim, lëshimet që u bëri Berisha nga Janullatosi tek falja e detit"

Për Berishën

"Sali Berisha e futi në Shqipëri Janullatosin, u dha grekëve hapësirën detare, furnizoi me naftë makinën ushtarake të Milosheviçit, kanë bërë gjithçka për pushtetin e tij, ndërsa shqiptarët e mbajnë të biblilosë në parlament".



-Sipas jush duhet të ringrihet ushtria, duhet të rritet fuqia ushtarake?

Jo sipas meje, por edhe sipas NATO-s, një nga pikat e para të NATO-s parashikon që, vendi partner duhet të ketë kapacitete mbrojtëse për veten e vet. Dhe Shqipëria nuk i ka. Ushtria duhet të ringritur. Pse Greqia është kaq shumë e armatosur? Nuk e di Greqia se është në mbrojtjen e NATO-s? Po Bullgaria dhe vendet e tjera nuk e dinë? Vetëm shqiptarët shkatërruan armatimin. Asnjë vend nuk është çarmatosur si Shqipëria. Nuk ka asnjë kapacitet mbrojtës, përveç aleancës. Ndaj flet ai greku. Por, thirrjet e tij janë një mësim shumë i mirë, se konjukturat mund të lëvizin, politika lëviz me ditë, por kapacitetet mbrojtëse duhen vite që të bëhen.

-Ditën e premte, në një takim në Tiranë, organizuar nga PBDNJ, deputetja greke e Qipros, Eleni Theoharous, ka artikuluar disa deklaratat provokuese. A duhet të kishte një reagime të autoriteteve shqiptare?

Për mua ajo duhej të shpallur automatikisht 'non grata'. Duhej të nxirrej automatikisht nga Shqipëria. Sa i takon pretendimeve për Vorio-Epirin, grekët kanë mbetur në mesjetë, por puna është se ata janë fqinjët tanë.

-Në skenë është rikthyer edhe marrëveshja e detit. Kryediplomati grek u referua një aludimi të Sali Berishës, sipas të cilit Turqia ka ndërhyrë për të mundësuar rrëzimin e marrëveshjes në Gjykatën Kushtetuese...


Këtu nuk ka ndonjë gjë të veçantë. Sali Berisha për pushtetin e tij bën çdo gjë. Është më keq se sa Esat Pashë Toptani në këtë pikëpamje. Sali Berisha e futi në Shqipëri Janullatosin, u dha grekëve hapësirën detare, furnizoi me naftë makinën ushtarake të Milosheviçit, kanë bërë gjithçka për pushtetin e tij, ndërsa shqiptarët e mbajnë të biblilosë në parlament. Ai nuk është në linjë direkte me thënien e fundit që pati me grekët, por e dinte se atyre do t'u interesonte dhe u krijuar lidhja menjëherë.

-Duke u ndalur tek aktualiteti politik, a e keni parashikuar një rezistencë të tillë kundër zbatimit të Reformës në Drejtësi?

E kemi thënë prej dy vitesh që Reforma në Drejtësi, në qoftë se bëhet, do të bëhet me tekst të

Sistemi mbrojtës

"Jo sipas meje, por edhe sipas NATO-s, një nga pikat e para të NATO-s parashikon që, vendi partner duhet të ketë kapacitete mbrojtëse për veten e vet. Dhe Shqipëria nuk i ka. Ushtria duhet të ringritur. Pse Greqia është kaq shumë e armatosur? Nuk e di Greqia se është në mbrojtjen e NATO-s?".



shkruar nga të tjerët, me urdhër po nga të tjerët për të votuar, dhe kështu ka ndodhur. Përsëri shqiptarë po operojnë me të gjitha mënyrat për ta penguar, për ta denaturuar dhe për t'i hequr thelbin e karakterit. Kështu që në sjelljet e fundit të Partisë Demokratike dhe të gjyqtarëve të Shqipërisë është përpjekja e fundit e tyre për ta sabotuar Reformën në Drejtësi. Shpresojnë që ta shtyjnë deri në zgjedhjet e fundit dhe ta agjësojnë totalisht nëse do të ketë ndryshime të raporteve politike. Është e qartë që, i gjithë ky krim i gjithanshëm që ka ndodhur në Shqipëri, politik, ekonomik dhe njerëzor, ku në thellësi të tij janë politika dhe drejtësia, vetvetiu ata nuk do të pranojnë që të shkojnë para drejtësisë. Ndaj, do të përdorin të gjitha mënyrat për ta sabotuar. Duke e parë veten të imunizuar për 20 e ca vite, në këtë mjedis të kontaminuar drejtësi-politikë-shoqëri civile, po bëjnë rezistencë. Vetëm në Shqipëri dekorohen tradhtarët, për shembull, dhe ne bëjmë sehir, në vend që ata të venë automatikisht pas hekurave. Dikush ka deklaruar se ka vuarë dhe prerë, ndërsa portretin e vëmë në vilën e ish-kryeministrit të Shqipërisë. Në këtë kaos dhe shoqëri të kontaminuar vetiu nuk është e lehtë që ta vendosësh trenin në shinat e veta. Por shpresojmë tek përqendrimi amerikan dhe evropian që Shqipëria të bëhet. Nuk mund të mbajnë ato tani që, një shtet në një pozicion shumë të rëndësishëm, të jetë një kalbësirë. Kjo është e vetmja shpresë. Por është e pamundur që reforma të bëhet nga vetë shqiptarët.

Dokumenti, sa do të paguhen policët për çdo orë shtesë

Forcat e rendit do të marrin 5-10 mijë lekë për çdo orë shërbimi ekstra

ESIONA KONOMI
TIRANE

Ministria e Brendshme është duke përgatitur një vendim i cili pritet të kalojë në Këshillin e Ministrave, që përcakton se sa do të paguhet çdo polic, sipas gradës që ka, për çdo orë punë jashtë ngarkesës normale. Dokumenti i cili është dërguar për mendim në 10.11.2016 Ylli Manjanit si Ministër i Drejtësisë dhe Arben Ahmetaj, Ministër i Financave, i siguruar nga Shqiptarja.com përmban tabelën e plotë të shifrave,

Pr. Vendimi
TIRANE

Ministria e Brendshme pritet të kalojë për vendim në qeveri një skemë të re të funksionimit të policisë, orareve të punës, lejeve të paguara dhe pushimeve vjetore apo ditore sipas turnit të shërbimit. Shqiptarja.com sjell dokumentin që mban firmën e Saimir Tahirit, dhe që përcakton këto rregulla. "Koha normale e punës/shërbimit për punonjësit e Policisë së Shtetit është 40 orë në javë. Për efekt të llogaritjes së pagës orare, muaji llogaritet mesatarisht me 174 orë pune. Punonjësit të Policisë i sigurohet një pushim ditor i pandërprerë prej 11 orësh para marrjes së shërbimit/punës. Shërbimet e Policisë si rregull organizohen sipas një planifikimi 24 orësh, me tume, nga tetë orë secili. Kohëzgjatja e punës natën nuk mund të jetë më shumë se 8 orë pa ndërprerje. Ajo duhet të paraprihet ose të pasohet me pushim ditor të menjëhershëm. Punonjësi i Policisë që shërben natën, në ditët e pushimit javor e të festave zyrtare, brenda kohëzgjatjes normale ditore të punës, përfiton një shtesë mbi page në masën 20% për çdo orë pune e shërbimi të kryer nga ora 19.00 deri në orën 22.00; 50% për çdo orë pune e shërbimi të kryer nga ora 22.00 deri në orën 06.00 dhe 25% për çdo orë pune të kryer në ditët e festave zyrtare

ku thuhet se polici, për çdo orë punë jashtë ngarkesës, do të paguhet nga 5 mijë lekë të vjetra për inspektorin si grada më e ulët, në 10 mijë lekë të vjetra në orë për kryekomisararin si grada më e lartë. Këto para do të grumbullohen sipas një marrëveshjeje paraprake nga institucioni apo personi juridik publik apo privat që kërkon ndihmën e

policisë për mbarëvajtjen e një aktiviteti. "Policia e Shtetit ofron shërbime shtesë sipas mundësisë që ka dhe kundrejt pagesës për persona juridikë e fizikë, publikë ose privatë, mbi bazën e kërkesës së tyre për: Mbështetje në zhvillimin e aktiviteteve kulturo-kombëtare dhe ndërkombëtare, si: panaire, ekspozita, teatro, koncerte, shfaqje, festivale të



ndryshme, në mjedis të zhvillimit të aktiviteteve sportive kombëtare dhe ndërkombëtare; Mbështetje të Zyrës së Përmbarimit Gjyqësor Privat të Republikës Shqipërisë, gjatë

ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, titull ekzekutiv; Mbështetje për sigurinë gjatë transportit të vlerave monetare dhe vlerave të tjera, nga sistemi bankar i nivelit të dytë në

PËRLOGARITJA E TARIFËS PËR NJË PUNONJËS POLICIE SIPAS GRADËS PËR NJË ORË PUNË

	Tarifa mujore për një punonjësi të policisë së shtetit	Inspektor	Nënkomisar	Komisar	K/Komisar	Në lekë
1	Paga bazë për gradë	49000	65500	72000	87000	
2	Shtesë page për vërshtësi dhe rreziqe	5500	5500	5500	6300	
3	Shtesë për vjetërsi pune	1960	2620	2880	3000	
4	Llogaritja e punës jashtë kohës normale 25% në ditët e zakonshme	14115	18405	20095	24000	
I	Shpenzime për paga mesatare mujore	70575	92025	100475	120300	
II	Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore 16.7%	11786	15368	16779	20090	
III	Shpenzime operative mujore	4239	3722	3722	4000	
1	Veshmbathje (69.324 lek/vit rol drejtues, 81.742 lekë/vit rol zbatues)	2823	2305	2305	2500	
2	Ndërlidhje (Vitin e parë 20.750 lekë dhe cdo 5 vjet)	346	346	346	346	
3	Ndërlidhje (4150 lekë në vit)	346	346	346	346	
4	Tarifë për armë brezi +14 fishekë (7200 lekë copa dhe 100 lekë copa)	725	725	725	725	
IV	SHUMA (I+II+III)	86600	111115	120976	148307	
V	Tatimi mbi vlerën e shtuar	17320	22223	24195	29661	
VI	Totali (IV+V)	103920	133338	145171	177968	
	Tarifa e pagës për 1 punonjësi policie për 1 orë punë jashtë kohës normale	597,24	766,31	834,32	1060	

Skema, ja sa leje marrin policët për çështje familjare

Si ndahen orët e punës, lejet e paguara dhe pushimet pas turneve të natës

dhe ditët e pushimit javor. Punonjësi i Policisë gëzon të drejtën e pushimeve vjetore të paguara, si më poshtë: a) 40 dite kalendarike për punonjësit e policisë me gradë "Drejtues" deri "Drejtues madhor"; b) 35 ditë kalendarike për punonjësit e policisë me gradën Nënkomisar, Komisar dhe Kryekomisar. c) 30 ditë kalendarike për punonjësit e policisë me gradën Inspektor. Gjatë kryerjes së pushimeve vjetore

punonjësi trajtohet financiarisht në të njëjtën masë me pagën që merr punonjësi kur është në punë/shërbim. Punonjësi i cili ndërpret marrëdhëniet e punës me strukturat e Policisë, trajtohet menjëherë financiarisht për ditët e pushimit vjetor të pakryera, të llogaritura në raport me kohëzgjatjen e tij të punës brenda vitit kalendarik. Punonjësit të Policisë i jepet leje e pagueshme për rastet si më poshtë: Martesën e tij

7 ditë; Martesën e fëmijës 5 ditë; Lindjen e fëmijës për baballarët 3 ditë; Vdekjen e prindërve, të gjyshërve, të bashkëshortes/it, të fëmijës, vëllezërve, motrave 7 ditë; Ndërrim të banesës 3 ditë; Sëmundje të rënda të fëmijëve, prindërve 7 ditë dhe përgatitjen dhe mbrojtjen e titujve të gradave shkencore për punën që kryejnë 10 ditë", -thuhet në projekt vendimin që mban firmën e ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri.



LEJET E PAGUESHME	
Punonjësit të Policisë i jepet leje e pagueshme për rastet si më poshtë:	
a)	Martesën e tij : 7 ditë
b)	Martesën e fëmijës: 5 ditë
c)	Lindjen e fëmijës për baballarët: 3 ditë
d)	Vdekjen e prindërve, të gjyshërve, të bashkëshortes/it, të fëmijës, vëllezërve, motrave: 7 ditë
e)	Ndërrim të banesës: 3 ditë
f)	Sëmundje të rënda të fëmijëve, prindërve: 7 ditë
g)	Përgatitjen dhe mbrojtjen e titujve të gradave shkencore për punën që kryejnë : 10 ditë.

→ PAGESA

Paratë e përfituara nga pagesat e atyre që kërkojnë ndihmën e policisë do të përdoren për shlyerjen në kohë të pagave të punës së mbingarkesës, por jo për shpërblime.

territorin e Republikës së Shqipërisë; Shoqërimet në rastet e zhvillimit të aktiviteteve kulturore, sportive, që zhvillohen në rrugët urbane dhe interurbane kryesore dhe dytësore, si dhe të automjeteve që transportojnë ngarkesa të rrezikshme dhe jashtë norme; etj. Këto shërbime nga strukturat e policisë ofrohen mbi kohën normale të punës. Drejtuesit e Njësisë Buxhetore në Policinë e Shtetit, në qendër dhe në bazë, me marrjen e kërkesës nga subjektet juridike ose jo publike për shërbime policore shtesë, përcaktojnë mënyrën e ofrimit të shërbimit shtesë në bazë të procedurave standarde të punës së Policisë së Shtetit", -thuhet në shkresën që Ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri u ka dërguar kolegëve të tij, Manjanit dhe Ahmetaj. Sipas relacionit shoqëruar të këtij projektvendimi, thuhet se "Shërbimet shtesë që ka ofruar Policia e Shtetit gjatë vitit 2013 janë 52.000 orë mbi mbikohën normale të punës, me vlerë 86.000.000 lekë, në vitin 2014 janë 346.000 orë me vlerë 174.531.000 lekë, në vitin 2015 janë 402.000 orë me një vlerë 202.626.000 lekë. Këto shërbime policia i ka ofruar, jo se ka kapacitete të lira, por sipas mundësisë që ka, duke ngarkuar me mbi kohë pune punonjësit e saj (mbi 40 orëshin javor të punës. Por pavarësisht angazhimit me mbikohë punë, në disa raste punonjësit e policisë, nuk janë paguar brenda afatave ligjore për shkak të mungesës së fondeve)".

Djali i Remzi Hoxhës: Kumbaro dhe Sefgjini shantazh Berishës

“Berisha përgjegjësi kryesor për vrasjen e babit tim, pa ndikim ndërkombëtar nuk zbardhet çështja”

Djali i Remzi Hoxhës, Ardi Hoxha, akuzon ish-kryeministrin Sali Berisha si përgjegjës kryesor për torturimin dhe zhdukjen e babit të tij, për arratisjen e Ilir Kubaros, për pengimin e drejtësisë dhe për shpërbimin e të implikuarve të tjerë me poste shtetërore. Në një lidhje telefonike për Report Tv, Ardi Hoxha ka pohuar se Ilir Kubaros dhe Arben Sefgjini, kanë shantazhuar Sali Berishën dhe për këtë arsye, Berisha i bëri drejtorë. Sipas Hoxhës, faji për vrasjen e Ilir Kubaros meqenëse ishte i arratisur, ndërsa ka theksuar se zinxhiri i të aplikuarve në zhdukjen e babit të tij fillon nga Sali Berisha, Bashkim Gazidede, Ilir Kubaros, Arben Sefgjini, Budjon Meçe dhe Avni Koldashit. Hoxha ka deklaruar se ka zhvilluar një takim edhe me kryeministrin Edi Rama për këtë çështje. Reagimi i Ardi Hoxhës vjen në një kohë kur në Tiranë kanë zharkuar për një mision gjashtëditor një grup ekspertësh të OKB, për shqyrtimin e masave që ka marrë Shqipëria për gjetjen e personave të zhdukur me forcë.



Ardi Hoxha



Ilir Kubaros



Remzi Hoxha

→ SHANTAZHI

“Edhe se Berisha është shantazhuar nga këta persona. Edhe nga Arben Sefgjini, edhe nga Ilir Kubaros. Këta presin që secili prej tyre të vdesë që të mos dalin informacione për babanë tim”.

Një grup ekspertësh të OKB po zhvillojnë një vizitë gjashtëditorë në Tiranë, për shqyrtimin e masave që ka marrë Shqipëria për gjetjen e personave të zhdukur me forcë...

Unë ka dëgjuar për këtë vetëm nga mediat dhe jo nga burimet e shtetit. Ne jemi në pritje nëse do na flasë dikush nga shteti shqiptar për këtë.

Ardian, në çfarë fazë janë hetimet për zhdukjen e babit tuaj, Remzi Hoxha?

Ne si familje kemi luftuar 17 vite që të vërtetojmë që ishte SHIK-u i Sali Berishës ai që kishte zhdukur dhe mbytur babin tim. Në një prononcim të Sali Berishës, të para dy ditëve, thotë që nuk ka dijeni për të, por në fakt kjo është bërë me urdhrat të tij dhe në bashkëpunim me njerëzit e tij më të afërt, të cilët edhe i ka mbrojtur ndër vite, me gjithë sistemin e drejtësisë të kontrolluar nga Berisha. Kemi arritur që ta vërtetojmë që, po ata njerëz që patën dyshimin që nga dita e parë, e zhdukën dhe e vranë babin tim, duke i fshehur edhe shtrat. Personat e implikuar nga më i larti janë: Sali Berisha, Bashkim Gazidede, Ilir Kubaros, Arben Sefgjini, Budjon Meçe dhe Avni Koldashit. Pas 17 vitesh, edhe nga Prokuroria e Sali Berishës del që faji i mbetet vetëm Ilir Kubaros, për shkak se atij i ka mbetur në dorë, por më shumë është shkak se, Kubaros ishte i arratisur dhe ishte i mbrojtur po ashtu nga avokatët e Sali Berishës. Kur thotë ky që u lanë të pafajshëm, në fakt, në vitin 2003, u burgosën këta persona dhe Sali Berisha i amnistoi. Ata u liruan nga burgu, bilës u dëmshpërblen. Morën edhe para nga shteti, nga populli. Tani u vërtetua që, SHIK-u i Berishës e ka bërë, faji i ka mbetur Ilir

Kubaros, i cili është i dënuar me 15 vite burgim dhe është në arrati. Është i kërkuar. Edhe në Interpol të Shqipërisë, me siguri ka njerëz të Sali Berishës, pasi nuk i çojnë gjërat përpara. Unë besoj që shteti shqiptar ka mundësi që ta gjejë dhe të na tregojë ku janë eshtrat. Berisha është pyetur në baza ditore për eshtrat e babit tim, por ai thotë që nuk ka dëgjuar ndonjëherë për Remzi Hoxhën dhe se për herë të parë ka dëgjuar prej Adem Demaçit. Berisha po gënjën. Tani bëhen 21 vite që po gënjën. Përgjegjës kryesor për zhdukjen e babit tim dhe për mungesën e eshtrave është Sali Berisha.

Si ka ecur hetimi tani që e majta është në pushtet?

Ne kishim një shpresë

Dëshmia:

“Kubaros fshihet në Cardiff, ruhej nga një polic civil”

sh-kreu i SHIK-ut të Tiranës, Ilir Kubaros, i dënua i vetëm me 15 burg për torturimin dhe zhdukjen e Remzi Hoxhës, por që u shpëtoi autoriteteve britanike, dyshohet se jeton në qytetin e Cardiffit, në Britaninë e Madhe. Pas një rrëfimi fillimisht për “Report Tv” dhe më pas për të përditshmen “Dita” nga gazetari, Muhamed Veliu, për dinamikën e zhdukjes së Ilir Kubaros, ka mbërritur dëshmia e parë se ku ish-drejtori i SHIK mund të fshihet. Kështu, mesditën e djeshme, në Illogarinë e Instagramit të gazetarit Veliu, një shqiptar i cili banon në Cardiff, ka shkruar se e ka parë Ilir Kubaros bashkë me bashkëshorten në Cardiff. Ai pretendon se, Kubaros rreth gjatë kohës duke kontrolluar me sy njerëzit rreth vetes, por në largësi ishte një person tjetër që e ruante. “E kemi parë bashkë me gruan në supermarketin e madh të qytetit. Rrinte gjithë kohën duke kontrolluar me sy njerëzit rreth vetes, por në largësi ishte një person tjetër (besoj polic civil britanik) që e ruante”, thuhet në mesazhin e dërguar nga shqiptari që jeton në qytetin e Cardiffit, të Britanisë së Madhe. Për herë të parë pas 5 vitesh hidhet dritë për vendin e mundshëm ku fshihet njeriu mi i kërkuar nga drejtësia shqiptare dhe ajo britanike.

→ PËR BERISHËN

“Ai thotë që nuk ka dëgjuar ndonjëherë për Hoxhës dhe se për herë të parë ka dëgjuar praj Adem Demaçit. Berisha po gënjën. Përgjegjës kryesor për zhdukjen e babit tim dhe për mungesën e eshtrave është Berisha”.

shumë të madhe kur fitoi PS-ja, jo se e simpatizojmë PS, por të paktën nuk është grupi që janë të implikuar në zhdukjen e babit tim. Tani është vërtetuar me gjyq që krimin e kanë bërë Sali Berisha me njerëzit e tij. U gëzuan pa masë dhe që nga dita e parë kërkuan takim me kryeministrin Rama. Takimi i parë u bë pas 4 muajsh pasi u zgjodh kryeministër. Ai na tha që deri në vitin 2017, deri në momentin që ta ketë presidentin PD, që i bie që ta kontrollojë drejtësinë, do të jetë më e vështirë. Ne, në përplekjet që kemi bërë, e kemi pasur shumë të vështirë. Jemi refuzuar çdo herë sepe njerëzit e Sali Berishës kanë qenë në çdo institucion. Më pas, me

kalimin e viteve, kjo shpresë u zbeh sepe e shohim që shumë pak ka lëvizje në këtë rast. Ne u munduam shumë para një viti që ta ngremë çështjen e babit tim në axhendë të shtetit shqiptar, por për fat të keq u përmend nja një javë dhe u mbyll me aq. Edhe kjo strukturë nuk tregoni ndonjë interesim. Nga gjykimi, fillimisht ka qenë i implikuar edhe Budjon Meçe, i cili ka qenë vartës i Ilir Kubaros dhe që bashkë me Kubaros, këtre të dyve u ka mbetur në dorë baba im. Gjatë gjykimin sajojnë që Budjon Meçe gjendet në gjendje komë në një spital privat dhe se nuk mund të shihet nga askush. Si rrjedhojë, Budjon Meçe del nga procesi i akuzës. Tashmë ai person është i lirë dhe nuk merret shteti me atë. I bëj thirrje publike shtetit që të merret me Budjon Meçen, pasi edhe ky person është i implikuar dhe ka shumë dëshmi. Me të vërtetë shpresat janë shumë të vogla, por shpresoj që me vullnet të shtetit ta zgjidhë këtë çështje. Rruga e vetme e jona është të merremi me institucione të nivelit evropian. Këtë rrugë jemi duke e ndjekur. Për këtë rrugë jemi duke u përgatitur.

Kush e pengoi procesin e ekstradimit?

Gjatë procesit të ekstradimit, njerëzit që ishin në organet e Shqipërisë e bllokuan procesin. Herë dërgonin një dokument mangët, herë një tjetër, e bënin punën që të zvarritej. Edhe për këtë duhet të ketë një proces penal.

Kush mendoni se janë njerëzit që e kanë ndihmuar Ilir Kubaros për t'u arratisur nga Anglia?

Janë njerëzit e Berishës. Avokatët që e mbrojnë për arratisje, ishin po të njëjtit avokatë që mbrojnë atë. Unë jam i bindur se Sali Berisha e di me saktësi se ku fshihet Ilir Kubaros. Sepse këta e shantazhojnë njëri-tjetrin. Edhe Bashkim Gazidede e bëri drejtor, edhe Arben Sefgjinin drejtor të Tatimeve. Këta njerëz ishin duke u hetuar për arratin e babit tim, ndërsa Berisha i emëroi në poste. Edhe Berisha është shantazhuar nga këta persona. Edhe nga Arben Sefgjini. Edhe nga Ilir Kubaros. Këta presin që secili prej tyre të vdesë që të mos dalin informacione për babanë tim.

Amendonis do të vendoset ndonjëherë drejtësi për këtë çështje?

Mendoj se drejtësia vonon, por nuk harron. Do dali drejtësi një ditë. Ne jemi munduar me vite që ta zgjidhim këtë çështje në mënyrë njerëzore dhe ligjore. E shohim që pa ndikim ndërkombëtar në Shqipëri nuk bëhet asgjë. Ne do e ngremë rastin tonë në nivel të strukturave evropiane. Evropa t'i kërkojë Shqipërisë që ta zgjidhë këtë çështje. Unë jam i bindur që do vijë dita që të gjejmë eshtrat e babit tim. Dhe atij do t'i abejmë një varr ashtu siç e meriton.

NJOFTIM

2. SHOQËRIA PËRMBARIMORE “616/A” SHPALL PËR SHITJE PASURITË E PALUAJTSHME

I. Njesi me sip. 74.8 m2, nga e cila 67.4 m2 ndertese me nr. pasurie 5/82, vol.18, faq.143 , e ndodhur në zonën kadastrale nr. 8281, Lagjia nr. 1, Pogradec. Vlera fillestare e pasurisë 3.040.000 (tre milion e dyzet mijë) lekë II. Ndertese me sip. 20.08 m2, nr. pasurie 5/74, vol.19, faq.58 , e ndodhur në zonën kadastrale nr. 8281, Lagjia nr. 1, Pogradec. Vlera fillestare e pasurisë 1.057.301 (njëmiljon e pesëdhjet e shtatë mijë treqind e një) lekë

ANKANDI ZHVILLOHET DITËN E PREMTE NË DATËN 16 DHJETOR 2016

Personat e interesuar mund të paraqiten në adresën Lagjia Nr; 3, Rruga: “Andon Xoxe”, Pogradec ose të kontaktojnë në numrin 069 25 85 612 ose në e-mail: shoqeria616a@gmail.com

NJOFTIM

1. SHOQËRIA PËRMBARIMORE “616/A” SHPALL PËR SHITJE PASURINË E PALUAJTSHME

I. Truall me sip. 110.5 m2, nr. pasurie 5/80, vol.6, faq.41 , e ndodhur në zonën kadastrale nr. 8281, Lagjia nr. 1, Pogradec. Vlera fillestare e pasurisë 2.660.800 (Dy milion e gjashtëqind e gjashtëdhjet mijë e tetëqind) lekë

ANKANDI ZHVILLOHET DITËN E ENJTE NË DATËN 15 DHJETOR 2016

Personat e interesuar mund të paraqiten në adresën Lagjia Nr; 3, Rruga: “Andon Xoxe”, Pogradec ose të kontaktojnë në numrin 069 25 85 612 ose në e-mail: shoqeria616a@gmail.com



“Koalicioni PS-LSI ka ende potencial për të shfrytëzuar”

Kreu i LSI-së, Ilir Meta: Shurdhësia dhe indiferenca, janë ushqimi kryesorë i pesimizmit

Konventa Kombëtare e Zgjedhore e Lëvizjes Socialiste për Integrim është mbledhur djeg në ambientet e Pallatit të Sportit “Asllan Rusi” për nisur procesin e zgjedhjeve të strukturave drejtuese të kësaj force politike. Përveç delegatëve të zgjedhur rreth një muaj më parë, drejtuesve të LSI-së në të gjitha nivelet, ministra, deputetë, anëtarë të Këshillave Bashkiakë, të pranishëm në këtë konventë ishin edhe të ftuar një sërë personalitetesh të jetës publike brenda dhe jashtë vendit. Punimet e konventës janë ndjekur nga përfaqësues të shumtë të trupit diplomatik në Tiranë, deputetja e PS-së, Valentina Leskaj, përfaqësuesi i PD-së, Tritan Shehu, Kryetari i PDIU, Shpëtim Idrizi, Kryetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, Kryetari i Partisë Demokratike Shqiptare të Maqedonisë, Menduh Thaçi, Drejtor politik i Partisë Demokratike të Socialistëve të Malit të Zi, Tarzan Milosevic,



përfaqësuesi i SYRIZA-s dhe anëtar i Parlamentit Grek, Janis Karaganis, Zv.Kryetari i Parlamentit të Malit të Zi dhe deputet i Forcës së Re Demokratike, Genc Imam Neku, etj. Në fjalën e tij përshëndetëse, Kryetari i LSI-së, Ilir Meta tha se në gjithë këto vite të ekzistencës së saj, LSI ka qenë një barrikadë e fortë ndaj konfliktualitetit, që mbjell prapambetje, varfëri dhe armiqësi e ndasi mes shqiptarëve. “Ndaj politika jonë ka qenë dhe mbetet, mirëkuptimi, bashkëpunimi, dialogu dhe konsensusi. Ne jemi këtu që të kërkojmë një rrugë zgjimi të potencialit e pafundme të Shqipërisë dhe të shqiptarëve, të cilat politika nuk ia shfrytëzuar dhe nuk ia dëgjuar si duhet. Shurdhësia dhe indiferenca, janë ushqimi kryesorë i pesimizmit dhe ndoshta arsyeja kryesore që ky vend nuk është aty ku duhet të ishte. Por ne po kërkojmë atë që me heshtje të gjithë e pranojmë kudo, në shtëpi, në shkollë, në kafene, në ambientet e punës, në shoqëri, një shans për të gjithë për të ndryshuar veten, për

t'u dëgjuar e për t'u përfshirë për një jetë më të mirë dhe për një Shqipëri më të begatë”, - shtoi Meta. Kryetari i LSI-së theksoi se koalicioni qeverisës ka akoma potencial të lartë, por të pashfrytëzuar ende, për të krijuar një sinergji dhe dinamikë më të lartë në plotësimin e premtiveve zgjedhore dhe përballimin e sfidave zhvillimore. Ndërkaq, Meta u zotua se do të angazhohet për të realizuar me përgjegjshmëri maksimale të gjitha detyrimet që vijnë nga ligji i dekriminalizimit me qëllim që, ai jo vetëm të zbatohet e të përsoset më tej, por as të mos u shkojë mendja dikujt me probleme serioze që të hyjë e të përfaqësojë qytetarët shqiptarë në Kuvendin e Shqipërisë dhe në çdo institucion publik. Gjithashtu, në fjalën e tij Kryetari i LSI-së tha se rekomandimet e OSBE-ODIHR për reformën zgjedhore duhet të adresohen më nënrye urgjente, veçanërisht për të vendosur një standard të pakompromentueshëm të transparencës së financimit të partive, të pastërtisë ligjore të kandidatëve dhe të penalizimit të shitblerjes dhe tjetërsimit të votës.

Deputeti i CDU/CSU: Ilir Meta, lider kyç në stabilitetin e Ballkanit

Gianni Pittella: Koalicioni juaj progresist po hap bisedimet për anëtarësim

Punimet e Konventës Kombëtare Zgjedhore të LSI-së i përshëndeti edhe Tobias Zech, deputet i CDU/CSU në Bundestagun Gjerman, njëkohësisht zëvendës-president i Partisë Popullore Europiane në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Në fjalën e tij, Tobias Zech vlerësoi figurën e Kryetarit të Lëvizjes Socialiste për Integrim, Ilir Meta, si një nga politikanët kyç në stabilitetin e Ballkanit dhe në procesin integruar të Shqipërisë. “I nderuar Kryetar Meta! Ju dhe partia juaj në shkuarën keni bërë një punë të shkëlqyer në drejtim të integritimit të Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian. Kryetari Meta ju jeni një lider kyç në Ballkan për stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e Ballkanit. Kemi



njohur punën që ju keni bërë në të shkuarën, gjithashtu jemi të sigurt për punën që do të bëni

ju në këtë drejtim në të ardhmen”, - tha përfaqësuesi i CDU/CSU në Bundestagun Gjerman. Punimet e Konventës Kombëtare të LSI-së i përshëndetën edhe përfaqësues të partive politike të rajonit si edhe Kryetari i grupit Socialdemokrat në Parlamentin Europian. Gianni Pittella, Kryetari i Grupit Socialdemokrat në Parlamentin Europian iu drejtua të pranishmëve në Konventë me një përshëndetje nëpërmjet një video-mesazhi. Në fjalën e tij, Pittella theksoi se do të mbështesë perspektivën evropiane të Shqipërisë për çeljen e negociatave për anëtarësim duke vlerësuar



Gianni Pittella

kontributin e LSI-së në qeverisje. “Të dashur shokë e shoqe! I dashur Ilir! Jam i lumtur që i drejtohem Konventës suaj, sepse ndjehem shumë afër Shqipërisë dhe familjes progresiste politike, pjesë të së cilës mund të më konsideroni edhe mua. Ju duhet të ndjeheni krenar që Shqipëria nën drejtimin e koalicionit progresist ka bërë progres të qëndrueshëm drejt çeljes së bisedimeve për anëtarësimin në BE. Unë do të insistoj pranë institucioneve evropiane për të theksuar nevojën e një kalendari për negociatat me Shqipërinë si mundësi më e mirë për të njohur përjekjet tuaja”, - tha Pittella.

PËRSHËNDETJET KRYESORE NË KONVENTËN E LSI:

Silva Caka, kandidatë për N/kryetare të LSI:

“Duhet të punojmë për t'ia dalë, duhet që t'i japim vetes një shans, për të ndihmuar edhe të tjerët. Duhet t'u japim të tjerëve një shans, për të ndihmuar njëri-tjetrin dhe të gjithë së bashku t'i japim një shans Shqipërisë, që ajo të bëhet më e mirë dhe më e sigurt për ne e fëmijët tanë.”

Ylli Manjani:

“Populizmi dhe polarizimi janë dy sëmundje që duhen shëruar me reforma. Reforma e sistemit politik është me rëndësi për demokracinë. Thelbi i reformës politike është reformimi i partive. Modeli i LSI është një model suksesi. Por duhet të ndryshojmë sistemin zgjedhor ku vota të shërbejë si zgjedhje. Sistemi zgjedhor nuk mund të trajtohet si kontratë koncesioni! Polarizimi reduktohet vetëm me ekonomi të zhvilluar. Pa ekonomi të zhvilluar nuk ka shoqëri të drejtë.”

Klajda Gjoshja:

“LSI në themel të funksionimit të saj ka frymën e dialogut dhe të zgjidhjeve që i shërbejnë vendit, larg retorikave, larg demagogjive, duke u bërë faktori kryesor i stabilitetit politik në vend. LSI ka sjellë një kulturë të re të politikbërjes dhe të vazhdojë në të ardhmen të forcojë dhe garantojë këtë lloj kulture.”

Tarzan Miloseviç, Drejtor i Politikës dhe Partisë Demokratike të Socialistëve të Malit të Zi:

“E falënderoj Kryetarin Meta në emër të Partisë Demokratike të Socialistëve për përkrahjen që i dha Malit të Zi në anëtarësimin në NATO. Jam i befatur në këtë konventë që shikoj se sa të rinj marrin pjesë dhe shikoj që partia juaj do të ketë të ardhme”.

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj:

“Dëshiroj sot t'ju them se u binda se LSI-ja në rrugën e saj politike tani jo vetëm që ka identitetin e saj, argumentet dhe njerëzit e saj, por është kthyer edhe në shpresë për suksesin e Shqipërisë dhe shqiptarëve. Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, kolegëve të mi, që janë të shumtë sot, janë edhe aleancën e të rinjve, ju urojme sukses në këtë Konventë dhe në rrugëtimin e mëtejshëm”.

Përfaqësuesi i SYRIZA-s, Yannis Karagiannis:

“Zoti dhe fqinji”. Për këtë arsye ne gjithmonë jemi përpara me fëmijët për të ecur dhe për të bashkëpunuar. Në rastin tonë, ky është vizioni jonë që ne kemi për bashkëpunimin me Shqipërinë”.

Nënkryetari i Parlamentit të Malit të Zi, Genci Nimanbegu:

“Zhvillimet demokratike për ne shqiptarë po ecin në kahun pozitiv. Dy vitet e fundit po shfrytëzojmë mundësitë t'i bashkëngjitemi familjes evropiane, jo me vlera materiale, por me vlera etike dhe demokratike. Të shfrytëzojmë shansin, t'i bashkëngjitem shoqërinë tonë Evropë. Të ruajmë aleancën për integrimin, ky të jetë synimi ynë i përbashkët. Edhe i shqiptarëve në Malin e Zi edhe të shqiptarëve kudo që ndodhen”.

Llalla rrëzon PD për Artur Bushin: Është i pastër

Prokuroria përgjigje KQZ-së: Kryebashkiaku i Krujës nuk preket nga dekriminalizimi



Artur Bushi


ESIONA KONOMI
TIRANE

Kryebashkiaku i Krujës, Artur Bushi nuk do të preket nga ligji i dekriminalizimit. Pretendimeve të opozitës dhe akuzave direkte të Partisë Demokratike për përfshirje të Bushit në veprimtari të paligjshme në Itali ju ka dhënë përgjigje që në 9 nëntor Prokuroria e Përgjithshme. Prokuroria e njësisë së posaçme për zbatimin e ligjit të dekriminalizimit, Rovena Gashi ka mbyllur hetimet për këtë çështje me konkluzionin se kryebashkiaku i Krujës nuk është subjekt i ligjit të dekriminalizimit. Ky konkluzion i është dorëzuar menjëherë pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili tashmë do të marrë vendim për mbylljen e verifikimeve për këtë funksionar publik. Shqiptarja.com disponon vendimin e arsyetuar të prokurorisë të mbërritur në KQZ, i cili është përmbledhës i hetimeve të nisura 7 muaj më parë sipas ligjit të dekriminalizimit. Në formularët e vetëdeklarimit, kryebashkiaku i Krujës, Artur Bushi pranonte se ishte ndaluar dy herë në Itali, një herë në 1996 për shfrytëzim prostitucioni dhe së dyti në 2010 për trafik droge. Bushi thoshte se në të dy rastet, çështja është sqaruar dhe hetimet janë ndër-

prerë pasi është vërtetuar mos përfshirja e tij në asnjë nga akuzat e pretenduara. Menjëherë, PD kërkoi verifikimin e formularit të Bushit, e më pas, vetë KQZ i kërkoi Llallës që të hetonte mbi çështjet e më sipërme. Lidhur me këto dy raste, Prokuroria e Përgjithshme ka dërguar kërkesa për informacion dhe ka shkëmbyer të dhëna hetimore me institucionet italiane dhe me EU-

ROPOL-in, ku gjithsej janë hetuar katër çështje të përmendura në formularin e dekriminalizimit, apo në akuzat e opozitës. Përveç shkëmbimeve me palën italiane dhe institucionet evropiane, vetë kryebashkiaku i Krujës ka sjellë disa vërtetime që tregojnë se dosjet ndaj tij janë mbyllur. Bushi ka dorëzuar një

vërtetim i gjendes gjyqësore në Itali ku tregohet se nuk ka asnjë "njollë" në të shkuarën e tij penale në shtetin fqinj, një kërkesë pushim hetimesh nga prokuroria e Busto Arsizios për ngjarjen e drogës për shkak të mungesës së elementeve hetimore, një vendim i të njëjtës gjykatë për revokim të masës së arrestit ndaj Bushit, si edhe një vendim pushimi nga gjykata italiane pasi prokuroria ka rindërtuar ndodhjet ku konkludon mos ekzistencën e kushteve për ndjekje penale ndaj tij. Në këto kushte, prokuroria e Prokurorisë së Përgjithshme, Rovena Gashi, arrin në përfundimin se gjatë këtyre hetimeve ka kryer një verifikim



PROKURORIA

Në 9 nëntor prokuroria e njësisë së posaçme për zbatimin e ligjit të dekriminalizimit, Rovena Gashi ka mbyllur hetimet për këtë çështje me konkluzionin se kryebashkiaku i Krujës nuk është subjekt i ligjit të dekriminalizimit.

HETIMET

Bushi ka dorëzuar një vërtetim i gjendes gjyqësore në Itali ku tregohet se nuk ka asnjë "njollë" në të shkuarën e tij penale në shtetin fqinj, një kërkesë pushim hetimesh nga prokuroria e Busto Arsizios.

Reagimi

Noka: Rama u hakmor ndaj Kukësit, i hoqi një mandat



Kukësi është përçaktuar se nuk do të nxjerrë më 4 deputetë, por vetëm 3. KQZ miratoi dhe që këtë garku ti hiqet 1 mandat. Për deputetin Flamur Noka, i cili në dhjetor 2012 ishte protagonist i një prej debateve më të forta për ndarjen e mandateve në periudhën para zgjedhjeve parlamentare, heqja e mandatit është hakmarrja e fundit e kryeministrit Rama ndaj Kukësit dhe kukstanëve. Sipas Nokës me këtë veprim Rama dhe qeveria e tij dëshiron ta godas Kukësin edhe në përfaqësim, por ka harruar se shumë shpejt kukstanët do ta rrëzojnë. "Nuk më duket e paparashikuar, pasi në vazhden e urrëjtjes që ka ndaj Kukësit e kukstanëve Edi Rama dhe qeveria e tij edhe tek përfaqësimi duan ta godasin siç e kanë goditur tek varfëria e skamja. Hakmarrja e fundit ishte ti heqë një deputet. Për qeverinë e Edi Ramën Kukësi mundësisht të mos jetë por ne do të jemi, do rezistojmë dhe do ta rrëzojmë. Është hakmarrje pse Kukësi nuk ka pranuar të nënshtrohet gjeneshtrave të tij", -tha Flamur Noka.

ZGJEDHJET 2017

Ndarja e re, një mandat më pak Kukësit, Korçës dhe Beratit

Harta e re elektorale, Tirana fiton dy mandate, Durrësi një, rrezikohet PD në veri

Në zgjedhjet 2017 do të ketë një hartë të re elektorale. Më shumë deputetë do të ketë në Tiranë e Durrës, u hiqet nga një mandat Korçës, Beratit e Kukësit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miratoi dje ndryshimet në mandatet e qyteteve, ku gjithsej do të jenë 140 deputetë. KQZ ndau numrin e mandateve në bazë

të përllogaritjes së bërë duke iu referuar numrit të popullsisë së dhe formulës së përllogaritjes së mandateve. Sipas ndarjes së re, në Qarkun e Beratit të Kukësit dhe të Korçës të ketë përkatësisht nga një mandat deputeti më pak. Këto mandate kalojnë 2 për qarkun e Durrësit. Kështu harta elektorale do të jetë ndryshe në zgjedhjet e ardhshme. Në bazë të një përllogaritje që ka bërë komisioni i posaçëm i reformës zgjedhore rezulton se ka ulje të numrit të popullsisë në qarkun e Kukësit dhe KQZ miratoi sot që këtë qarku ti hiqet 1 mandat dhe nga 4, të zbrësë në 3, edhe qarku i Beratit do të ketë të njëjtin fat duke zbritur numri i mandat, nga 8 në 7 e po ashtu Korça nga 12 në 11. Këto tre mandate deputetësh pritet të kalojnë në dy qarqe më të mëdha në atë të Tiranës dy mandate



më shumë duke u bërë nga 32 në 34 dhe atë të Durrësit që bëhet 14 nga 13 që ishte në zgjedhjet e fundit parlamentare të 2013. Lëvizjet e popullsisë dhe lindshmëria foshnjore ishin arsyt që çuan në ndryshimin hartën e mandateve të deputetëve në zgjedhjet e ardhshme parlamentare.

OFERTË PUNËSIMI

Kompania mediatike Shqiptarja.com kërkon të punësojë agjent marketingu që plotëson kriteret e mëposhtme:

- TË KETË ARSIM TË LARTË
- TË KETË PËRVOJË PUNE
- TË JETË I GATSHËM PËR TË PUNUAR NË TERREN

Personat e interesuar të dërgojnë CV e tyre në adresën: marketing@shqiptarja.com

Misioni i panjohur i të besuarës së Berishës në Moskë në prill 2012

Edit Harxhi lloboi për forcimin e marrëdhënieve me Rusinë. Kërkesa e Tiranës: Berisha në Rusi, Lavrov në Shqipëri



THANAS MUSTAQI
TIRANË

Në vitet 2011-2012 Shqipëria përpjeqej të vinte në funksionim të gjitha nivelet e marrëdhënieve me Rusinë, duke siguruar një ftesë për kryeministrin Berisha në Petërburg dhe një vizitë të kryediplomatit rus Lavrov në Shqipëri. Këto fakte bëhen të ditura në një intervistë që i ka dhënë agjencisë shtetërore ruse të lajmeve ITAR-TASS zëvendësministrja e Punëve të Jashtme Edit Harxhi, më 12 prill 2012. Ndërkohë është i pashpjegueshëm fakti që ndërsa MPJ-ja dhe mediat ruse i bënë jehonë vizitës të Harxhit në Moskë, vartësit e saj në Tiranë nuk e pasqyronin në sajtin e Ministrisë së Punëve të Jashtme vepërimitarë në "Romën e Tretë". Për më tepër që Harxhi, një nga njerëzit më të besuar të Berishës dhe PD-së, kishte arritur sukses, teksa siguroi një ftesë për Kryeministrin shqiptar në forumin ekonomik të qershorit 2012 në Shën-Peterburg. Po hedhim dritë për një vizitë të gjatë të ish-nr. 2 të MPJ-së, Edith Harxhi në Moskë, por që nuk është bërë publike as nga MPJ-ja dhe as nga mediat shtetërore. Përtej misterit që shkakton ky fakt, ngjallin interes deklarimet e Harxhit në vendin e stepave të pamat.



Sali Berisha

TATIM PULSI

"Tani në kuadrin e NATO-s po formohet në mënyrë aktive sistemi evropian i mbrojtjes nga raketat. A po planifikon Shqipëria t'i bashkohet kësaj strukture, a do të instalohen në të ardhmen në territorin shqiptar elemente të sistemit pan-evropian të mbrojtjes nga raketat?", kjo ishte një nga pyetjet e porositura nga lidhësit e Rusisë për agjencinë e shtetërore telegrafike ITAR-TASS për t'u bërë zëvendësministres shqiptare të Jashtme Edith Harxhi. Por, ajo, me elegancë, përdori një dredhi ala Berishë në përgjigjen e saj: "Që nga viti 2009, Shqipëria është anëtare e NATO-s. Angazhimi ynë në Aleancë nuk konsiston vetëm në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në botë në tërësi, si edhe në rajon, por edhe në pjesëmarrjen në operacionet paqeruajtëse. Do të vazhdojmë të përmbushim detyrimet tona në kuadrë të ISAF-it në Afganistan, si dhe në operacione të tjera të NATO-s në të gjithë botën. Shqipëria është një vend i cili jo vetëm garanton siguri, por edhe e prodhon, dhe, duke qenë një shtet i tillë, ne

Rusia në Ballkan Deklarata e Harxhit: "Ndërveprimi në Ballkan krahe për krahe me Rusinë ka shumë rëndësi për garantimin e sigurisë në rajon"

kemi instrumentet përkatëse për zgjidhjen e çështjeve të agjendës ndërkombëtare. Pozicioni ynë mbetet i pandryshuar lidhur me çështje të ndryshme në OKB, OSBE dhe Këshillin e Evropës. Në bisedimet me Vladimir Titovin u konstatua se negociatat në kuadrë të Këshillit Rusi-NATO duhet të vazhdojnë, nuk ka rëndësi se në çfarë niveli do të bëhen". Rusia tatoi pulsën për faktin se në vitin 2008 Berisha kërkoi që radarët amerikanë anti-raketë të instaloheshin në Shqipëri, gjë që solli reagimin e ashpër të Moskës. Se sa me merak e ka këtë problem, mjafton të citojmë radion shtetërore "Golos Rossii" (Zëri i Rusisë) në një

lajm të 17 prillit: "Rusia synon të vendosë një radar mbi-horizontal në territorin e Transnistrias. Stacioni i ri i radiolokacionit, i përfshirë në sistemin e paralajmërimit të sulmeve raketore, do të jetë një nga përgjigjet e Rusisë ndaj vendosjes së Mbrojtjes Evropiane Antiraketë dhe krijimit të bazave ushtarake të NATO-s në Rumani". Sikurse ka dalë nga dokumentet e shklasifikuara amerikane, në vitin 1961 Presidenti Xhon Kenedi anuloi një bombardim atomik të Shqipërisë për shkak të një radari sovjetik të Pakit të Varshevës në ishullin e Sazanit, me t'u prishur marrëdhëniet e Hoxhës me Hrushovin.

Por Moska e sotme është dhe pragmatiste. Sipas njoftimit për shtyp të MPJ-së ruse, në konsultimet midis Titovit dhe Harxhit, më 4 prill, "u diskutuan çështje të ndërveprimit të dy vendeve në organizatat ndërkombëtare, veçanërisht në kontekst të kryesimit të ardhshëm të Shqipërisë në Këshillin e Evropës, një numër çështjesh të politikës globale dhe gjendja në Evropën Juglindore". Me sa duket, Rusia mund t'i jepte kënaqësi Tiranës duke i çuar ftesë Kryeministrin Berisha për një forum ekonomik në


NË FOTO:
Moskë, më 4 prill 2012. Konsultime politike ruse-shqiptare midis zëvendësministrave përkatës V. Titov dhe E. Harxhi

qershor dhe ku të takonte kryeministrin e ri rus. Të paktën, kështu del nga intervista e Harxhit që priste të realizohej ky event.

NOSTALGJIA

"Po bëjmë përpjekje të aktivizojmë lidhjet tona", tha në intervistë Harxhi, e cila 9 ditë më parë, më 3 prill, në universitetin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Federatës Ruse MGIMO, në një leksion kushtuar zhvillimit të marrëdhënieve miqësore midis Rusisë dhe Shqipërisë, tregoi me hollësi mbi bazat e bashkëpunimit, që u vendosën në marrëdhëniet mes dy vendeve në vitet 1940-50. Harxhi nënvizoi se kujtimi për këto tradita është ende i gjallë në Shqipëri. Por, me sa duket, rusët janë mosbesues. Në një shkrim të 19 gushtit 2009 gazeta zyrtare e qeverisë ruse botoi artikullin me titullin "Kryeministri shqiptar akuzoi Rusinë se po përpjeqej "të kthejë Bashkimin Sovjetik".

Kreu i qeverisë shqiptare Sali Berisha, me t'u kthyer nga ceremonia e hapjes së Lojërave Olimpikë, në një konferencë shtypi të improvizuar, e gjykoj ashpër agresionin e Moskës kundër shtetit të lirë të pavarur dhe i bëri thirrje bashkësisë ndërkombëtare të ndërhynte me urgjencë për të rregulluar gjendjen. Sipas fjalëve të kryeministrin të Shqipërisë, Rusia ne veprimet e saj nuk do as më shumë as më pak "të kthejë Bashkimin Sovjetik". Për Kremlin, "hipokrizia e shqiptarëve, natyrisht, shpjegohet me faktin se ata thjesht përsërisin fjalë për fjalë çka u thonë amerikanët". Por Berisha ka ndryshuar. Madje, ai u tregua tejet i sjellshëm, kur priti një vit më parë në një audiencë drejtorin e Antidrogës Ruse dhe urdhëroi aderimin e Shqipërisë në Pesëshen e udhëhequr nga Rusia dhe Serbia për të rrethuar Kosovën me një "kordon sanitar" për luftën kundër narkotrafikut. Jo vetëm kaq, Harxhi u udhëzua të deklaronte në intervistën e cituar se Shqipëria beson që "ndërveprimi në Ballkan krahe për krahe me Rusinë ka shumë rëndësi për garantimin e sigurisë në rajon". Berisha u ka kërkuar rusëve të fusin në Shqipëri një degëzim të gazsjellës rus "Rryma Jugore".



DOKUMENTI

Mbi konsultimet politike ruse-shqiptare

Më 4 prill, V.G. Titov, zëvendësministër i Punëve të Jashtme të Rusisë, zhvilloi konsultime me E. Harxhin, zëvendësministër e Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë. Palët shkëmbyen mendime mbi një gamë të gjerë çështjesh që lidhen me bashkëpunimin e dyanshëm dhe tema aktuale të agjendës ndërkombëtare. Vëmendje e veçantë iu kushtua grafikut kontakteve të ardhshme ruse-shqiptare, duke përfshirë edhe ato nën linjë e ministrive së punëve të jashtme, zgjerimit të marrëdhënieve tregtare-ekonomike, zhvillimit të bashkëpunimit në fushën e arsimit dhe kulturës. U diskutuan çështje të ndërveprimit të dy vendeve në organizatat ndërkombëtare, veçanërisht në kontekst të kryesimit të ardhshëm të Shqipërisë në Këshillin e Evropës, një numër të çështjeve të politikës globale dhe gjendja në Evropën Juglindore.



Leksioni

Zëvendësministrja Harxhi, takim me të rinjtë rusë diplomatë të ardhshëm

Më 3 prill 2012 në departamentin e politikës së BE-së në Institutin mësimor Evropian pranë universitetit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Federatës Ruse MGIMO mbajti një leksion mysafirja e tij, zëvendësministrja e Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Edit Harxhi. Leksioni i Edit Harxhit iu kushtua zhvillimit të marrëdhënieve miqësore midis Rusisë dhe Shqipërisë. Ajo tregoi me hollësi mbi bazat e bashkëpunimit, që u vendosën në marrëdhëniet mes dy vendeve në vitet 1940-50, dhe nënvizoi se kujtimi për këto tradita është ende i gjallë në Shqipëri, njoftoi MGIMO. Duke folur për bashkëpunimin ekonomik mes Shqipërisë dhe Rusisë, E. Harxhi vuri theksin në interesin që ka Shqipëria për tërheqjen e investimeve ruse në zhvillimin e burimeve hidroenergjetike të vendit, si dhe foli për planet e ndërtimit të një rrjeti HEC-esh në lumenjtë malorë të Shqipërisë. Drejtim tjetër i bashkëpunimit është zhvillimi i turizmit. Për këtë arsye, që nga viti i kaluar në Shqipëri për periudhën e verës është regjimi i vizave për qytetarët rusë. Mysafirja u ndal në detaje në atë punë që po kryen qeveria për marrjen e statusit të vendit kandidat në Bashkimin Evropian.



NË FOTO: Zëvendësministrja e Jashtme e Shqipërisë, Edit Harxhi (e para nga e majta), dhe ambasadori shqiptar në Moskë Sokol Gjoka me pedagogë dhe studentë rusë në universitetin e diplomacisë në Moskë, më 3 prill 2012.

Po aktivizohen lidhjet shqiptare-ruse të viteve 1940-50

Intervista e 12 prillit 2012 agjencisë shtetërore ruse informative ITAR-TASS me Edit Harxhin

Ju erdhët në Moskë për konsultime në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Federatës Ruse. Na tregoni se cilat ishin çështjet që u prekën në bisedimet me homologun tuaj rus Vladimir Titov? A u diskutua grafiku i vizitave të ardhshme të zyrtarëve rusë dhe shqiptarë dhe në ç nivele?

Shpreh mirënjohje të thellë për ftesën që m'u bë nga kolegu im Vladimir Titov për një vizitë në Moskë për vazhdimin e konsultimeve politike. Në vitin 2010 konsultime të tilla bëmë në Shqipëri. Ftova Vladimir Titovin të vinte në Tiranë. Si gjithmonë, konsultimet janë zhvilluar në mënyrë konstruktive. Sot diskutuam probleme të marrëdhënieve në formatet dypalëshe dhe shumëpalëshe. Çështja më e rëndësishme që prekëm sot, lidhej me formatin e vizitave shtetërore në vendet tona në të gjitha nivelet, duke filluar nga krerët e Ministrive të Jashtme. Kemi përgatitur tashmë ftesën për Sergej Lavrovin [ministër i Punëve të Jashtme i Federatës Ruse] për të vizituar Tiranën. Ministri ynë i Punëve të Jashtme [Edmond Haxhinasto] ka shprehur dëshirën për të ardhur në Moskë. Do të donim të përfshinin të gjitha nivelet në zhvillimin e marrëdhënieve ruse-shqiptare. Vizitat dypalëshe mund të shpeshohen dhe në një nivel më të lartë, duke pasur parasysh dhe fushën ekonomike. Presim që kryeministri ynë [Sali Berisha] të jetë i pranishëm në forumin ekonomik të Shën-Peterburgut në muajin qershor [2012], në të cilin mund bëhen bisedime me homologun rus për çështje konkrete ekonomike. Niveli i qarqullimit të mallrave midis Rusisë dhe Shqipërisë është i ulët në krahasim me ato mundësi që kemi. Mund të hapet epokë të re në bashkëpunimin dypalësh, duke zhvilluar një forum të përbashkët ekonomik.

Vitin e kaluar, një forum i tillë u bë në Moskë, kurse vitin tjetër do të donim ta mbanim në Tiranë. Pas formimit të qeverisë së re në



Faksimile e sajtit të agjencisë shtetërore ruse informative ITAR-TASS, ku botohet intervista e 12 prillit 2012 e kësaj agjencie me zëvendësministrin e Punëve të Jashtme të Shqipërisë Edit Harxhi, me titullin: "Shqipëria përpiqet të vejë në funksionim të gjitha nivelet e marrëdhënieve me Rusinë".

Federatën Ruse është planifikuar sesioni i komisionit rus-shqiptar ekonomik në pjesëmarrjen e kabinetit të ri. Nga pala shqiptare këtë takim e mbulon ministri i Ekonomisë [Nasip Naço]. Shpresojmë se mbledhja do të mbahet sa më shpejt e mundur në Tiranë. Do të donim gjithashtu të shihnim investitorë rusë në Shqipëri. Aktualisht kjo gjë është një nga objektivat kryesorë në marrëdhëniet ekonomike. Ndërkaq kemi përvojë pozitive në shkëmbimet ndër-parlamentare. Për shembull, spikerja e parlamentit tonë para pak kohësh ka qenë për vizitë në Moskë. Në një kohë sa më të shpejtë presim një vizitë në Shqipëri të kryetarit të komitetit për çështjet

ndërkombëtare të Dumës së Shtetit [dhoma e ulët e parlamentit të Federatës Ruse]. Gjithashtu i kemi dërguar ftesë spikerit të Dumës së Shtetit. Po bëjmë përpjekje të aktivizojmë lidhjet tona (starayemsva aktivizirovat nashi svyazi). Besojmë se ndërvëprimi në Ballkan krahpër krahp me Rusinë ka shumë rëndësi për garantimin e sigurisë në rajon.

A mund të jepni një prognozë të integritimit evropian të Shqipërisë?

Do të doja të theksoja se Shqipëria tashmë është në procesin e euro-integritimit. Kemi përmbyshur tashmë shumicën e kërkesave të BE-së për marrjen e statusit të kandidatit. Shpresojmë se do të marrim vlerësim

pozitiv nga ana e Brukselit në tetor 2012 lidhur me këtë status. Gjithashtu shpresojmë në fillimin e negociatave së shpejti. Hyrja në BE është përparësia numër një në politikën e jashtme të Shqipërisë, e cila ndodhet në Evropë dhe ka po atë kulturë evropiane dhe vlera si të gjitha vendet e tjera të Botës së Vjetër. Në këtë aspekt, presim vazhdimin e diskutimit midis Shqipërisë dhe BE-së. Do të jemi gati të bëjmë bisedime me BE-në, kur të përmbushim 12 kërkesat. Ndërlidhimet kryesorë për anëtarësim në BE lidhen me problemet e brendshme, ndonëse kemi arritur rezultate të mira kohët e fundit.

Tani në kuadrin e NATO-s po formohet në mënyrë aktive sistemi evropian i mbrojtjes nga raketat. A po planifikon Shqipëria t'i bashkohet kësaj strukture, a do të instalohen në të ardhmen në territorin shqiptar elemente të sistemit pan-evropian të mbrojtjes nga raketat?

Që nga viti 2009, Shqipëria është anëtare e NATO-s. Angazhimi ynë në Aleançë nuk konsiston vetëm në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në botë në tërësi, si edhe në rajon, por edhe në pjesëmarrjen në operacionet paqeruajtëse. Do të vazhdojmë të përmbushim detyrimet tona në kuadër të ISAF-it në Afganistan, si dhe në operacione të tjera të NATO-s në të gjithë botën. Shqipëria është një vend, i cili jo vetëm garanton siguri, por edhe e prodhon, dhe, duke qenë

një shtet i tillë, ne kemi instrumentet përkatëse për zgjidhjen e çështjeve të agjendës ndërkombëtare. Pozicioni ynë mbetet i pandryshuar lidhur me çështje të ndryshme në OKB, OSBE dhe Këshillin e Evropës. Në bisedimet me Vladimir Titovin u konstatua se negociatat në kuadër të Këshillit Rusi-NATO duhet të vazhdojnë, nuk ka rëndësi se në çfarë niveli do të bëhen.

Në një sërë vendesh të Ballkanit po rritet kërcënimi për konfrontim ndëretnik me pjesëmarrje të shqiptarëve. A mund të çojë kjo gjë drejt një skenari kosovar?

Çështja e Kosovës nuk ka qenë asnjëherë skenar. Shqipëria mendon se Kosova është çështje ndërkombëtare. Konsideroj se tani pikërisht është koha kur të gjitha vendet e Ballkanit po jetojnë në paqe dhe mirëkuptim. Ne u kushtojmë vëmendje të madhe çështjeve të bashkëpunimit rajonal. Një nga elementet e bashkëpunimit me vendet të gadishullit të Ballkanit synon shmangjen e skenarëve, keqkuptimeve apo interpretimit të gabuar të së kaluarës. Sikurse dihet, në disa vende të rajonit ka pasur raste që lidhen me probleme të motivuara etnikisht. Mendojmë se koha kur në Ballkan lindin çështje etnike, konflikte fetare dhe konteste territoriale, kanë marrë fund një herë e mirë. Ne besojmë dhe respektojmë plotësisht sovranitetin e shteteve. Në të njëjtën kohë përpiqemi t'u japim të gjitha vendeve të rajonit mesazhe korrekte paqeje dhe tolerance. Opinioni se në të gjitha konfliktet në Ballkan kanë gisht shqiptarët, është absolutisht i gabuar. Ndoshta ju gjithmonë kjo i referohet shtetit shqiptar, por duhet pasur parasysh se në rajon jetojnë 6-7 milionë shqiptarë, dhe ata kanë qenë gjithmonë dhe do të jenë faktor stabiliteti si në shkallë rajonale dhe më të gjerë. Imazhi i Ballkanit si qendër konfliktesh etnike nuk përputhet me realitetin. E tashmë jetojmë në një rajon të qëndrueshëm dhe të sigurt.

(shih: <http://www.itar-tass.com/c49/391031.html>)

Fier, teknologu u ther dhe u dogj, biseda me familjarët

Ende pa autor. Viktima, familjarëve po shkoj me disa shokë në një varrim

E qëlluan me thikë dhe më pas tentuan ta dëgjin me qëllim për të zhdukur gjurmët. Këto janë të dhënat e para hetimore që hedhin dritë mbi humbjen e jetës së teknologut të Uzinës së Naftës së Ballshit, Shefo Duraj. Katër ditë pas gjetjes së kufomës së 57-vjeçarit nga Mallakastër në pyll mjekët ligjorë kanë konfirmuar vrasjen e tij. Dyshimet e para të Policisë së Fierit se 57-vjeçari Shefo Duraj është vrarë, rezultuan të vërteta. Ngjarja mendohet të ketë ndodhur në 14 Nëntor kur Duraj me profesion teknolog në Uzinën e Ballshit komunikoi me familjarët në telefon duke i njoftuar se do të udhëtonte drejt Skraparit me disa shokë por humbi çdo kontakt ndërsa trupi i tij u gjet dy javë më vonë. Ekspertiza mjeko-ligjore saktësoi se viktima është vrarë me mjet prerës. Ka plagë vdekjeprurëse në brinjë dhe në kokë ndërsa trupi i tij është djegur pjesërisht. Burime nga grupi hetimor i ngritur për hetimin e ngjarjes thanë se autori ka dashur të humbasë gjurmët duke tentuar të dëgjë kufomën. Duraj kishte dalë nga turni i tretë kur foli për herë të fundit me familjarët. Pas kësaj telefonate ai humbi çdo kontakt ndërsa dy ditë më pas familjarët denoncuan

zhdukjen e tij. Policia nisi kërkimet në fshatin Kalenjë ku banonte 57 vjeçari, por trupi i tij u gjet vetëm dy javë më pas nga një bari në pyllin e fshatit.

TELEFONATA E FUNDIT ME FAMILJARET

Shefo Duraj me profesion teknolog në Uzinën e Naftës në Ballsh u zhduk më 14 Nëntor pa lënë gjurmë pasi doli nga turni i tretë në Uzinën

e Ballshit ku punonte prej 20 vitesh. "Po shkoj me disa shokë tek një mik në Skrapar për ngushëllim". Kjo ishte telefonata që teknologu në Uzinën e Naftës në Ballsh, Shefo Duraj bëri me familjarët pak pasi mbylli turnin e tretë, meson Shqiptarja.com. Pas kësaj telefonate ai nuk pasur asnjë kontakt me familjarët duke bërë që këta të fundit të denoncimin dy ditë më pas zhdukjen e tij.



Viktima Shefo Duraj

Shefo Duraj rezultonte i zhdukur prej datës 14.11.2016. Policia nisi kërkimet në zonë, por nuk gjeti asnjë gjurmë të 57-vjeçarit deri mbrëmjen se

martës kur një bari i zonës lajmëroi autoritetet për një kufomë në pyllin e fshatit Kalenjë ku edhe banonte 57-vjeçari.



Pista

Pas zbardhjes se rrethanave ne te cilat lu mor jeta teknologut, policia ka dhe pisten e pare ku dyshon se perse mund te kete ndodhur krimi makaber. Burime thanë per Shqiptarja.com se pista e hetimeve është ajo e hakmarrjes për një vrasje të përpara viteve '90 ku ka qenë i përfshirë një i afërm i viktimës.

NGJARJA NË TIRANË / KOTALDO LEZHJA ËSHTË SHPALLUR NË KËRKIM

Miku i 'të fortit' të M. Shyrit terrorizoi qytetarët



Kataldo Lezhja

Njeriu që terrorizoi qytetarët mbremjen e djeshme quhet Kataldo Lezhja. Ai njihet si mik i të fortit të rrugës "Myslim Shyri", Gjergj Cukali. Lezhja i shpëtoi Policisë duke ikur me vrap, ndërkohë që është shpallur në kërkim. Kataldo Lezhja është 25 vjeçari që terrorizoi Tiranën mbremjen e së premtes. Duke përdorur një makinë "Alfa Romeo" dhe i armatosur, Lezhja ka kërcënuar disa qytetarë. Ngjarja ka ndodhur në kryqëzimin e rrugës "Mujo Ulqinaku" dhe Rrugës së "Kavajës" ku Kataldo Lezhja bashkë me një person tjetër të quajtur B.K kanë kërcënuar qytetarët me armë zjarri. Një qytetar ka

telefonuar i alarmuar sallën operative të Policisë së Tiranës, duke denoncuar se persona të armatosur kanë kërcënuar disa qytetarë në rrugën "Siri Kodra" në kryeqytet. Telefonata ka vënë në lëvizje policinë e kryeqytetit e cila është nisur menjëherë në drejtim të vendit të ngjarjes. Në ndjekje të makinës "Alfa Romeo" u vendosën forcat "Shqiponja". Blutë ndoqën për disa minuta automjetin e denoncuar nga qytetari, ndërsa disa minuta më pas makina u gjet e braktisur mbi trafikndarësen e rrugës. Autorët ishin larguar ndërsa janë shpallur në kërkim nga policia. Nga kontrolli i makinës, efektivët e policisë kanë gjetur një sasi të


vogël kokaine në kroskot. Kataldo Lezhja është mik i ngushtë i Gjergj Cukalit, i cili njihet si i forti i rrugës "Myslim Shyri". Lezhja përveçse miqësisë që ka me Gjergj Cukalin është person me precedent penal. Ai është dënuar disa herë për plagosje dhe vjedhje. Vetëm në vitin 2015 ai është arrestuar dy herë nga policia në Tiranë. Në njërin prej tyre Lezhja ka plagosur dy persona për vendin e parkimit. Ai është arrestuar edhe 2 herë të tjera në vitin 2013, po për vendin e parkimit. Tashmë Kataldo Lezhja është shpallur në kërkim nga Policia e Tiranës dhe akuzohet se ka kërcënuar disa qytetarë, por edhe për armëmbajtje pa leje.

LAJME SHKURT

Shpërthen një bombol gazi lëndohen 2 të moshuar

Një bombol gazi e cila shërbente për ngrohje ka shpërthyer këtë mbrëmje në qytetin e Durrësit ku për pasojë kanë mbetur të lënduar 2 persona të moshës 77 dhe 73 vjeç. Ngjarja ka ndodhur në

banesën e dy të moshuarve, në zonën pranë Pallatit të Sportit "Ramazan Njala". Nuk dihen ende arsyet e shpërthimit të bombelës, sakaq policia ndodhet në vendngjarje ku po kryen të gjitha hetimet.



"TEC-i", tre persona në pranga nga policia për ankandet në Fier

Policia e Fierit ka ndaluar tre persona, që të tre ish-punonjës të TEC-it të Fierit dhe ka shpallur në kërkim dy të tjerë me akuzën e shpërdorimit të detyrës. Flamur Fejzulla, 49 vjeç, banues në Peshan të Fierit dhe ish-përgjegjës i TEC-it të Fierit, Artem Rusto, 43 vjeç, banues në Zharrës, ish-magaziniar po në këtë TEC dhe Qemal Vrenoz, 41 vjeç, ish-drejtor i TEC-it janë arrestuar, ndërsa në kërkim janë shpallur shtetasit me inicialet P.P. 53 vjeç dhe T.B., 65 vjeç, që të dy banues në Tiranë. Policia thotë se këta shtetas në bashkëpunim me njëri-tjetrin gjatë periudhës 2012-2013 që kanë qenë në detyrë i kanë shkakuar shtetit një dëm prej 209 milion lek nga ankandet publike të kryera në atë periudhë ku kanë favorizuar firmën e shtetasit T.B. Për këta shtetas Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg", ndërsa për shtetasin Qemal Vrenoz masën e sigurisë "Arrest shtëpie".



Dhunoj policët, në pranga vëllai i kryetarit të Bashkisë së Devollit

Altin Nallbati, vëllai i kryebashkiakut të Devollit, Bledjon Nallbati është shoqëruar në komisarjat pas një konflikti me disa efektivë policie. Sipas të dhënave nga burime jozyrtare, mësohet se Altin Nallbati është shoqëruar në komisarjat e Devollit, pasi ka goditur specialistin e SHÇBA, Devi Ago dhe bashkëshorten e tij, po punonjëse policie. Nallbati, ka shkuar në komisarjat pasi një person i afërm me të ishte shoqëruar për prerje dhe transport të paligjshëm të pyjeve. Altin Nallbati ka nisur të konfliktohet me bashkëshorten e Devi Ago e cila ishte në detyrë. Teksa ka dëgjuar konfliktin Ago ka shkuar dhe ka ndërhyrë por situata ka precipituar dhe ata janë goditur me njëri-tjetrin. Menjëherë Altin Nallbati është shoqëruar nga blutë e Devollit.



Altin Nallbati

Arrestohet shoferja përplasi për vdekje të moshuarin

Një 23-vjeçare është arrestuar nga Policia e Durrësit si shkaktare e aksidentit me vdekje ndaj një të moshuari në autostradën Tiranë-Durrës. Testi Hyst, e goditi 75-vjeçarin R.H në momentin që ky i fundit po kalonte trafik-ndarsen, duke e lënë të vdekur. Sipas policisë së Durrësit 23-vjeçaria, Hysi akuzohet për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, pasi mendohet se ka qenë me shpejtësi tej normave të lejuara. Ngjarja ka ndodhur mbrëmjen e djeshme dhe sipas Policisë përplasja e të moshuarit ka qenë e forte, çka ka sjellë vdekjen e menjëhershme të tij.

Fier, hodhi gruan nga pallati autori: E bëra në gjaknxehtësi

Ngjarja

Krimi tronditës ka ndodhur përpara syve të fqinjëve të familjes Ruko. Policia ka shoqëruar për në komisarjat autorin e dyshuar Fredi Rukon, ndërsa vijojnë hetimet për zbardhjen e shkaqeve të ngjarjes.



Dëshmia

E pamë me sytë tonë kur burri e hodhi nga dritarja e banjës. Dëgjua të bërtitura dhe pastaj pashë që ai e ngritit peshë dhe e hodhi Liljanën. Ishte e tmerrshme"



Policia arreston burrin Fredi Rruko, çiftit i ishte refuzuar azili në Gjermani

Një grua ka humbur jetën pasditen e kësaj të shtune në lagjen "Kryengritja" të qytetit të Fierit, pasi dyshohet se është hedhur nga bashkëshorti nga kati i katërt i apartamentit ku banonte. Viktima është identifikuar Liljana Ruko, 42-vjeç, e cila ka humbur jetën rrugës për në spital, ndërsa policia ka shoqëruar si të dyshuar për ngjarjen të shoqin e saj, Fredi Ruko. Burime pranë policisë së Fierit bëjnë me dije se mes çiftit ka pasur një sherr të çastit dhe dyshohet se autor i krimit është burri, duke hedhur poshtë kështu pistën e vetëvrasjes. Versioni i policisë konfirmohet edhe nga fqinjët e familjes Ruko, të cilët janë bërë dëshmitarë të këtij krimi tronditës. Një dëshmitare ka parë të gjithë

skenen e krimit kur Fredi Ruko kishte hedhur nga dritarja e tualetit, bashkëshortin, Liljana Ruko. Ajo tha për Shqiptarja.com se kishte dëgjuar të bërtitura dhe në atë moment gruaja është hedhur nga burri nga kati i katërt i pallatit. Ndërkohë, dy bashkëshortët kishin pak kohë që ishin kthyer nga Gjermania së bashku me dy fëmijët e tyre, ku mësohet se kishin shkuar për të përfituar azil politik. Autoritetet gjermane kanë refuzuar kërkesën e çiftit shqiptar, çka ka bërë që ata të rikthehen në vendlindje, në Fier.

FQINJA: E HODHI BURRI

"Liljanën e hodhi bashkëshorti nga dritarja e tualetit, e pamë me sytë tonë". Kështu rrëfen për "Shqiptarja.com" një fqinje e çiftit Ruko në Fier, ku gruaja,



Pamje nga vendi i ngjarjes



Liljana Ruko, humbi jetën pastaj pashë që ai e ngritit peshë dhe e hodhi Liljanën. Ishte e tmerrshme"-thotë fqinja. Ajo thekson gjithashtu se gruan e kanë gjetur të zhveshur dhe me trupin e lagur poshtë pallatit. "Ne e gjetëm të zhveshur dhe me trupin e lagur poshtë pallatit, siç duket sapo kishte dalë nga dushi". E pyetur nëse mes çiftit ka pasur probleme të

mëparshme, fqinja thotë se ishin një familje e përkryer. "Ishin çift dhe familje e përkryer, nuk kishim dëgjuar për probleme më para mes tyre", u shpreh ajo.

NGJARJA

Ka qenë ora 15:30 e kësaj të shtune kur në lagjen "Kryengritja" të qytetit të Fierit, një grua është hedhur nga kati i katërt i apartamentit.

TEK "UZINA E AUTOTRAKTORËVE"


Keqtrajtohet një person, i thyejnë brinjët në Tiranë

Një person është gjetur nga policia me plagë në fytyrë dhe me brinjë të thyera. Gruaja e tij kishte lajmëruar se i kanë rrembyer burrin. Mbrëmjen e djeshme në numrin e emergjencave 112, ka ardhur një telefonatë, se në zonën e njohur si "Uzina e Autotaktorave", një shtetas ishte keqtrajtuar fizikisht dhe

po mbahej, pa dëshirën e tij në një banesë, thotë policia. "Mënjëherë janë dërguar Shërbimet e Komisarjatisë të Policisë Nr.1, të cilët kanë marrë kontakt me shtetasen M. F., e cila sqaroi punonjësit, se bashkëshortin e saj, shtetasin G. F., e kishte goditur shtetas Besnik Sylaj dhe po e mbante pa dëshirën e tij në banesë". Eshhtë bërë e mund-

ur hapja e banesës, ku në brendësi të saj nuk është konstatuar asnjë person, por janë konstatuar disa njolla si ato të gjakut që dyshohej se mund të ishin të shtetasit G.F. Dje rreth orës 07:00, në ambientet e ish Uzinës së Autotaktorëve, është bërë e mundur gjetja e shtetasit G. F., i cili u dërgua në S.Q.U., pasi kishte dëmtime në pjesën e fytyrës

dhe të brinjëve, jashtë rrezikut për jetën. "Specialistët për Hetimin e Krimit të Komisarjatisë të Policisë Nr. 1, kanë organizuar punët ku kanë bërë kapjen dhe arrestimin në flagrancë të autorit të dyshuar, shtetasin: Besnik Sylja, 34 vjeç, banues në Tiranë, i dënuar më parë për "Shfrytëzim të Prostitucionit", tha policia.



LAJME SHKURT

Endri Dhimitri, nisin hetimet për vdekjen e 24-vjeçarit

Policia e Tiranës nisi hetimet për vdekjen e një 24-vjeçari që u gjet i vdekur në shtëpinë e tij në Tiranë për arsye ende të paqarta. Endri Dhimitri ishte vizituar në spital në datën 29 Nëntor. Pasi kishte konsumuar alkoool, 24-vjeçari është penguar gjatë ecjes. Për këtë arsye ka pësuar shembje dhe hemoragji të brendshme. Burime nga policia thanë se pasi ka marrë mjekimin, ai është larguar në shtëpi. Të nesërmen, në datën 30

Nentor, i riu ka ndjerë sërisht shqetësime dhe ka shkuar në spital, por mjekët e kanë këshilluar të marrë ilaçet dhe të largohej për në shtëpi. Pasi shkoi në shtëpi, Endri Dhimitri është ndjerë keq sërisht dhe shokët njoftuan ambulancën për ta dërguar në spital. Por i riu ndërroi jetë sapo ambulanca mbërriti në shtëpinë e tij. Burime nga policia thanë se pritet autopsia për të përcaktuar shkaku të vdekjes.



Endri Dhimitri

Elbasan, pranga të riut. Pengoi zbardhjen e vrasjes së Sllamit

Një i ri është vënë në pranga ditën e djeshme për vrasjen e Gazmend Sllami me armë gjahu në fshatin Gur i Zi në Elbasan. Naim Hazizi 27 vjeç është vënë në pranga ditën e djeshme nën akuzën se pengoi në zbulimin e së vërtetës për vrasjen e ndodhur në një kodër në fshatin Gur i Zi. Ndërkaj blutë kanë sekuestruar dhe armën e zjarrit. "Ky shtetas, u ndalua nga efektivat e policisë pasi dyshohet të ketë penguar në zbulimin e së vërtetës për vrasjen e ndodhur më datë 26 nëntor 2016 në një kodër në fshatin Gur i Zi". Për vrasjen në fjalë para pak ditësh u arrestua 21-vjeçari Altin Hazizi. Para trupi gjykoës, 21-vjeçari ka treguar se si kishte ndodhur ngjarja ku mbeti i vrarë shoku u tij Gazmend Sllami. Sipas tij, të dy të rinjtë kishin dalë për gjueti në kodrinën e fshatit të tyre, kur ai gabimisht shkrepri armën.



Gazmend Sllami

SHUHET ANDREA STEFANI

LAMTUMIRE KOLEG!

Gazetar i njohur e kurajoz, i pari që investigoi për thyerjen e embargos së OKB nga Berisha



Alba Malltezi

Lamtumirë Andrea, mendje e mprehtë dhe e drejtë. Do të të kujtoj gjithmonë për përllogaritjet e thjeshta në 1995 te Gazeta Shqiptare kur zbulove kontrabandën e naftës nga Shqipëria drejt Serbisë. Shqipëria e vogël importonte disafish me shumë naftë nga sa ishte konsumi i brendshëm. Ku shkonte? Pyesje t... Pastaj nuk duroje dot injorancën mes gazetarëve. Bëje kuçice në redaksi: Kush është skulptori që bëri 'Mëshirën'? Kur vendi pati nevojë, ti the gjithmonë të vërtetën. Nuk e bëjnë të gjithë... Dhe sa shumë mërzi sheshe ti



Edi Rama

Një lajm tronditës për humbjen e madhe të një njeriu e patrioti të mirë, gazetar i pakompromis e qytetar i angazhuar për idealet e idetë të besoi deri në fund!... Lamtumirë

ANDREA STEFANI



Erjon Braçe

Shuhet një idealist! Kurrë nuk e shiti mendimin e tij; Kurrë nuk bëri kompromis me të vërtetën; Kurrë nuk e tradhëtoi bindjen e tij! Jetoi ndershmerisht dhe kjo është shumë në këtë vend, por është shumë më tepër në gazetarinë e këtij vendi!

Botës mediatike shqiptare iu nda dje një nga zërat e fuqishëm, që u shua në Romë. Lajmi i kobshëm bëri të ditur se gazetari dhe analisti Andrea Stefani nuk arriti dot të mundë sëmudjen e rëndë në ezofag, e cila e ndau nga jeta para kohe, pavarësisht se Andrea nuk u dorëzua deri në momentin e fundit, duke tentuar t'i bëjë ballë të keqes që e kishte kapluar që nga vera e këtij viti. Jo vetëm për familjarët: humbja e tij është, në radhë të parë, një humbje për botën mediatike, atë të shkruar dhe vizive, të cilës ai i përkushtoi 26 vite.

Andrea do të kujtohet si një prej antikongformistëve të "pandreqshëm" me çdo pushtet që promovon padrejtësinë dhe pabarazinë para ligjit në Shqipëri. Dimensionit të tij profesional si gazetar do t'i bashkëngitej edhe aktivizimi i theksuar civil, veçanërisht në përpjekjet qytetare kundër korrupsionit dhe dominimit autoritarist të shtetit.

Andrea i përket brezit të gazetarëve shqiptarë të viteve '90. Ai filloi karrierën në vitin 1989 si gazetar i gazetës sindikale "Puna" dhe më pas vazhdoi si gazetar i lirë. Më parë kishte punuar si pedagog pranë shkollës ushtarake. Në vitin 1993, ai hyri të bënte pjesë në ekipin e parë të "Gazeta Shqiptare", e cila rinovoi shumë koncepte të të bërit gazetar në Shqipëri. Kolegët, me të cilët punoi në këtë gazetë, do ta mbajnë mend për profesionalizmin dhe veçanërisht kurajon, me të cilën investigoi dhe më pas publikoi zbulimin për herë të parë në shtyp të kontrabandës së naftës, që shteti shqiptar, në kohën kur presidenti Republikës ishte Sali Berisha, zhvillonte në thyerje të embargos së vendosur nga Organizata e Kombeve të Bashkuara kundër Jugosllavisë së drejtuar nga Sllibodan Milloseviçi. Me disa përllogaritje të importeve të naftës, të bëra nga ai në vitin 1995, në cilësinë e gazetarit të sektorit ekonomik, Andrea arriti të zbulojë se në Shqipëri hynin karburante që e kalonin dhjetëra herë aftësinë konsumatore të vendit. Zbuloi më tej edhe karvanin e autoboteve, që furnizonin regjimin gjakatar të ish-diktatorit jugosllav, duke kaluar kufirin nga Shqipëria,

që pasuroi drejtuesit e kohës së Berishës, duke damkosur shtetin tonë me një njollë të konsiderueshme. Që lidhej, jo vetëm me shkelje të një angazhimi ndërkombëtar, por edhe me dëmin e pallogaritshëm që kryhej ndaj vëllezërve të një gjaku në Kosovë, me furnizimin me karburant të makinës represive ushtarake të Milloseviçit, që lau Kosovën me gjak.

Andrea ka punuar në gazetën "Rilindja" të Kosovës që botohej në Tiranë. Prej vitit 1997, ai punoi në gazetën "Shekulli" si kryeredaktor i parë i saj, bashkëpunoi si opinionist me të përditshmet "Shqip", "Dita" etj. Por do të mbahet mend nga publiku edhe për qendrimit e palëkundura në vite në opinionet e tij sidomos në emisionet e opinioneve në televizionet kryesore të vendit.

Për shumë vjet drejtoi një program investigativ antikorruption, të titulluar "Hapur", që përgatiste botime dhe material televizive me karaktere investigative anti-korrupsion. Ishte autor i librit publicistik "Albanistan".

Ndërkohë, studentët e degës së gazetarisë do ta kujtojnë si pedagogun e përkushtuar.

Andrea njëherë si përkrahës i PS, edhe kur kjo ishte në opozitë, edhe i qeverisë Rama, por nuk ngurroi të thoshte së fundi fjalën e tij kundër ligjit për pronat, që përgatiti kjo mazhorancë, apo opinionin e tij se në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore luftimet ndërmjet palëve mund të cilësoheshin si "luftë civile", qendrime këto, ndryshe nga ato zyrtare.

Andrea zbrapsi me sukses tentativat qesharake për ta diskredituar si spiun të regjimit komunist, që u kryen me anë të dokumentave të falsifikuar në mënyrë të trashë, nga ana e militantëve pro-Berishës.

Miq të dhe të njohurit e përshkruajnë si një njeri trim dhe të papërkullor. Ai nuk e këshoi asnjëherë veten përballë një sëmudjeje të rëndë, që rezultoi madje e pashpresë, kur u konstatuan edhe probleme në sistemin kardiovaskular. Megjithatë, deri një ditë më parë se të largohej nga kjo jetë, ai ishte i vendosur të luftonte.

Do të ishte kjo, beteja e parë që humbi në jetë.

Të qoftë dhe i lehtë, koleg!



Mero Baze

lu vu dita-ditës në mënyrë manuale, të merrte kursin e dollarit në tregun e zi, që lëvizte pa ndonjë rregull të veçantë dhe ai donte të gjente mekanizmin që e lëvizte. Ishte si të kërkoje gjitpërën në kashtë, në një ekonomi pa rregulla, informale, pa prodhim kombëtar dhe pa banka e bursa. Andrea për një muaj resh shkante tek tregu para Bankës, mbante shënim dhe kthehej. Në fund kishte gjetur mekanizmin. Kishte krahasuar luhatjet e dollarit me autobotet e naftës që hynin në Kakavijë për në drejtim të Hanit të Hotit ku kalonin kontrabandë, duke thyer embargon me ish-Jugosllanë. Gjithçka përputhej. Kontrabanda diktonte kursin. Shkrimi i tij i shkurtër i kishte ngrënë gati një muaj, por unë e mbaj mend dhe pas 22 vjetësh. Është rasti kur këmbëngulja të bën gazetar dhe nuk të devijon nga e vërteta. Formimi i tij bazal ushtarak dhe pastaj studimet në Fakultetin Ekonomik e bënë atë një gazetar të disiplinuar dhe ndoshta themelues i ri gazetarisë së re ekonomike, pas viteve '90-të. Ky tipar i tij menjohet se dominoi gazetën e tij si gazetar. Ishte nga ata gazetarë që nuk i shmangej kurrë pozicionit.

Sokol Balla

Liria e shprehjes dhe e mendimit ka humbur një nga gjeneralët e saj. Andrea Stefani vendosi, jashtë dëshirës së tij dhe të të dashurve të tij, të na lërë shumë shpejt. Një sëmudje e rëndë e ndau nga jeta, sëmudje ndaj së cilës ai luftoi fort deri në sekondën e fundit. Andrea ishte kështu, një luftëtar. Në radhën e parë të atyre që mbronin lirinë, dhe dimensionin e saj të shenjtë që shqiptarët e rifituan 25 vjet më parë. Lirisë i kushtoi libra ndërsa armiqe të saj, gjithë jetën e tij. E provuan këtë rezistencë të këtij korifeu të gjithë me radhë. Nga e djathta në të majtë. E provoi Sali Berisha herën e parë dhe sidomos herën e dytë në pushtet. E provoi Edi Rama, kur tentoi t'i bënte atentat kushtetutës në 2008. E provoi Ilir Meta në 2011. E ndjeu në kurriz Lulzim Basha kur mori partinë në 2013.



Papërkulshmëria jote morale të bëri figurë të rrallë të gazetarisë shqiptare



NGA CARLO BOLLINO

Idashur Andrea, të njoha kur sapo kisha mbërritur në Shqipëri, 25 vjet më parë, dhe ti doje të bëheshe gazetar. Bashkë me ty, Armand Meron, Fatos Baxhakun, Edmond Laçin dhe Bajram Peçin, hapëm "Gazetën Shqiptare". Ishte viti 1993. Ti merresh me ekonominë dhe tregove menjëherë një talent të spikatur kritik, sëbashku me dëshirën për të mësuar, për t'u rritur e, mbi të gjitha, për të kuptuar, që më pas të bëhë një figurë tepër të rrallë të gazetarisë shqiptare. Rrugët tona profesionale u ndanë dhe më pas u ribashkuan e sërisht u ndanë, sepse kështu ndodh në zanatin tonë, por gjithnjë, sa herë që takoheshim, flisnim me njeri-tjetrin si në kohën kur punonim bashkë, me të njejtin entuziazëm, me të njejtën të qeshur ironike, me të njejtin belbëzim të lehtë. Ti mbete gjithnjë i njejtë: reflektues, studioz, anarkist, kontestues dhe, si të gjithë njerëzit inteligjentë, i vetëm me dashje.



(Në rreth) Andrea Atefani mes kolegëve të "Gazeta Shqiptare" në vitet '90

Një mundësi e shkëlqyer

Kredi Personale

Deri në **2.000.000** Lekë
për herë të parë pa kolateral

www.raiffeisen.al



**Raiffeisen
BANK**

Çmimet shpallen në Zagreb në datat 3 - 6 maj të vitit 2017

“Marubi” në garë me muzeun “Picasso”

Muzeu shqiptar i fotografisë është nominuar për çmimin “Muzeu më i mirë i vitit në Evropë”

Muzeu Kombëtar i Fotografisë “Marubi” në qytetin e Shkodrës është nominuar për çmimin “Muzeu më i mirë i vitit në Evropë”, ku do të konkurrojë me muzeun “Picasso” dhe të tjerë muze të rëndësishëm në Europë, ka pohuar drejtori i institucionit Luciano Bedeni. Ky është një ndër çmimet europiane më prestigjioze që do të jepet për muzet që kontribuojnë në tërheqjen e audiencës. Muzeu vlerësohet për faktin se u jep vizitorëve një atmosferë unike, duke i kushtuar vëmendje të veçantë edukimit të brezave në bashkëndarjen e një përgjegjësie shoqërore në kontekstin ku ata operojnë.

Drejtori i muzeut Luçjano Bedeni tha se ky nominim është ngjarja më e rëndësishme e muzeut. “Për këtë vit është evenimenti më i rëndësishëm i muzeut. Kuptohet edhe kjo për shkak të kohës së shkurtër që është inauguruar. Është një ndër që Marubi po konkurron me një prej emrave më të rëndësishëm, si muzeu “Picasso”, apo muze të tjerë shumë të rëndësishëm të Europës”, u shpreh Luçjano Bedeni. Ceremonia e ndarjes së çmimeve për të shpallur fituesin “Muzeu më i mirë i vitit në Evropë”, ku mes të nominuarëve është edhe “Marubi” do të zhvillohet në Zagreb në datat 3 deri në 6 maj të vitit 2017. Muzeu Kombëtar i Fotografisë “Marubi” u përfundua në maj të këtij viti. Brenda tij gjendet thesari i dinastisë së Marubëve, i cili përmbledh foto të bëra që nga themelimi i studios më 1856 dhe deri në vitin 1989. Muzeut “Marubi” i janë bashkuar edhe disa nga arkivat e tjera të



fotografisë shqiptare.

FAMA E “MARUBIT” PAS ÇELJES SË TIJ

Pa kaluar një vit nga çelja e tij,

interesi për muzeun Marubi ka qenë i madh. Lajmi ka pushtuar një sërë sajtesh të huaja i kanë kushtuar vëmendje. Një artikull për muzeun “Marubi” është publikuar

nga “Architizer”, databaza më e madhe e arkitekturës dhe shtëpia e “A+Awards” – programi çmimi global për arkitektët më të mirë sot. Një tjetër artikull është bërë

nga revista italiane e arkitekturës “DIVISARE”, si edhe nga Agjencia Ndërkombëtare të Lajmeve spanjolle EFE, nga revista e rëndësishme e arkitekturës “gooodo.hk”, si edhe një publikim nga prestigjioza e arkitekturës në botë, revista “Dezeen”, e cila është përqendruar te projekti arkitektonik i “Marubit”.

Në ekspozitën “Marubi” përveç fotografive artistike gjen imazhe artistësh si Tefta Tashko, Prek Jakova, Martie Kraja, foto nga historia e kulturës muzikore në fillim të shekullit e të tjera. Fotot e Marubit krijojnë imazhin e e Shqipërisë së një shekulli më parë kur mungonin rrugë, transporti, teatri, ekspozitat. Dhe megjithatë kishte kaq shumë shqiptarë nga të gjitha zonat shqiptare brenda e jashtë kufirit që merrnin rrugën për të bërë një foto në studion “Marubi”. Arkiva e pasur e tij me 500 mijë fotografi e ka zanafillën 160 vjet më parë, kur një italian me emrin Pjetër Marubi u vendos në Shkodër dhe çeli të parën studio fotografike në rajon. Rreth vitit 1850, jo shumë kohë pas shpikjes së fotografisë, Pjetër Marubi arriti në Shkodër. Aty i dha jetë studios së tij. Pas vdekjes së Pietros, asistenti i tij, Keli mori mbiemrin Marubi edhe si nderim për të. Ai e mbajti studion hapur dhe ia kaloi të birit, Gegë Marubit. Koleksioni me 150.000 xhama negativësh është interesant nga ana historike, sociologjike, kulturore dhe antropologjike e po ashtu nga ana artistike. Ngjarje nga historia e trazuar e Shqipërisë – nga periudha otomane te periudha komuniste, ritet sociale, kostumet folklorike dhe portrete grupesh të rëndësishme sociologjike mund të gjenden të gjitha në koleksion.

DRAMA

Luiza Xhuvani luan në Teatrin Eksperimental shqip dhe greqisht

Aktorja e njohur Luiza Xhuvani do të luajë në dramën “Një gur gabim” të regjisorit grek Theodoros Grampas. Shfaqja e realizuar nga kompania e Teatrit “Praksi Efta” do të ngjitet këtë fundjavë në skenën e Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli” dhe do të vijoj gjatë javës ditën e enjte dhe të premte deri në datën 17 nëntor. Përkthimi në shqip ka ardhur nga vetë aktorja Luiza Xhuvani, e cila e luan këtë rol në të dyja gjuhët. “Vështirë të luash në dy gjuhë por janë dy ingranazhe që i vë në lëvizje i njëjti motor. Janë pjesë të së tërës dhe janë sinkronizuar. Kjo është edhe gjetja e regjisorit. Këtu qëndron çelësi dhe e bukura. Është një udhëtim mes ëndrrës dhe realitetit”, u shpreh Xhuvani. Vepra “Një Gur Gabim” përshkruan marrëdhënien nënë e bijë, që ende vazhdon të jetë e vështirë që nga kohët e lashta. Regjisorit Theodoros Grampas e vlerëson përvojën e teatrit në dy gjuhë si një mënyrë për të kuptuar më mirë psikologjinë popullore. Drejtori i Teatrit eksperimental “Spahivogli” pohon se këtë



Luiza Xhuvani

fundjavë në këtë institucion do të shfaqet edhe premiera “Gjetja e festës”, ndërsa thekson se ardhja e kësaj vepre në Tiranë është pjesë e projektit të hapjes së teatrit edhe për premierat e vendeve fqinje. “Një gur gabim” do të luhet me skenografinë e kostumografinë e Kostandinos Zamanis dhe muzikën e Theodorit Ikonomu. Bashkë me aktoren shqiptare Luiza Xhuvani do të interpelojnë aktoret greke Xheni Stavropulos, Eleni Ludjana Thanasi e Peni Papajorgos.

PREMIERA

Mustafaj shfaq dokumentarin si po degradohet muzika shqiptare

Dokumentari më i ri Donika Mustafaj i referohet tronditjeve që ka pësuar kënga shqiptare nën presionin e fortë të shoqërisë së konsumit. Shqiptari i ka kënduar në mënyrë të magjshme dashurisë, me ndjeshmëri të lartë shpirtërore, me aftësinë për ta shprehur artistikisht këtë ndjeshmëri. Ky është plani paralel që autorja e dokumentarit vendos krahas muzikës së çakorduar të tallavasë që ka pushtuar tregun vitet e fundit. Analiza e e dukurisë ka kaluar në trekëndëshin krijues-këngëtar-media, ku lind, realizohet dhe shitet produkti. Të rinjtë thonë flalën e tyre. “Dokumentari ishte në kohën e duhur. Duhet të shmanget ky produkt i dëmshëm”, thotë autori i teksteve të 40 festivalet të këngës Jorgo Papingji. “Të tilla tema ka kohë që na mungojnë, madje janë specie në zhdukje. Ky dokumentar e ka problemin në ikje e sipër, por po largohet sistemi i krahasimit. Pra neqet e reja që ka ardhur, kjo këngë që po dëgjojmë ne sot duke u zbehur ajo që dëgjojmë ne që quhej kënga shqipe. Ne nuk kemi më këngë që mund ta meritojnë këtë emer. Pra




Donika Mustafaj

në momentin që u kap kjo është një shkullje veshi për gjitha institucionet, gjithë ekranet, e të gjithë njerëzve që merren me muzikë, art”, u shpreh Jorgo Papingji. Ndërsa autorja e dokumentarit Donika Mustafaj rrëfen motivet mbi të cilin e bazoi dokumentarin. “Paraqita disa shqetësime fillimisht të mijat, pastaj i paraqita për publikun, për të tëhequr vëmendjen

se ku po shkojmë. Për mua kënga është shumë e rëndësishme dhe në një farë mënyre kënga e dashurisë është dëshmitarja e jetës sonë”, është shprehur Mustafaj. “Kur kënga nuk ishte Pazar” është filmi i dhjetë dokumentar i Mustafaj, ku ndër të përfshihen “Magjia klarinetë, ustai i fundit”, kushtuar mjeshtrit të madh Laver Bariu, “Një amerikane në Tiranë”,

Kosova dhe Enver Hoxha



MBI KEQKUPTIMET E PËRSËRITURA HISTORIKE KOSOVË-SHQIPËRI

- Një libër i botuar së fundi (Esat Myftari, "Kosova dhe Enver Hoxha", Tiranë 2016), që dëshmon se ekzistojnë dallime të mëdha ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë edhe në perceptimet e historisë më të re
- Ky rrëfim përfshin marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, respektivisht ish-Jugosllavisë, që nga fundi i viteve '40

NGA MEHMET KRAJA

speciale ne faqet 16-17

Kolë Shiroka, mjeshtri i madh i karnavaleve

faqe 18-19



Kolë Shiroka u lind më 16 gusht të vitit 1900 në Shkodër. Rridhte nga një familje e vjetër peshkatarësh. (Siç duket mbiemrin e ka marrë nga vendi ku ka jetuar, në Shirokë). Ishte djalë i vetëm mes tri motrave. Edhe pse i tillë, ndërkohë që i ati Lushi dhe e ëma Silja e shikonin si sytë e

ballit, në moshën 13-vjeçare ai merr rrugët e dhimbshme të mërgimit. I merr ato rrugë, duke lënë pas si një peizazh të trishtuar fëmijërinë dhe plot ëndrra lundrimi me varkë... Do të punojë shërbëtor e berber nëpër dyert e shtëpive të Cetinës, në Mal të Zi, deri në vitin 1918.....

faqe 20-21

■ **Liriku i shquar/** Shaip Beqiri, për 50 vite, botoi vetëm katër libra 'themelore'

faqe 22

■ **Festivali/** "Bota e teatrit" në skenën e teatrit "Skampa" në Elbasanit

LIBRI | TEZAT

NGA MEHMET KRAJA

Libri i Esat Myftarit "Kosova dhe Enver Hoxha" është një rrëfim politik, pas leximit të dokumenteve të përzgjedhura dhe të klasifikuara të Ministrisë së Jashtme të Shqipërisë. Ky rrëfim përfshin marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, respektivisht ish-Jugosllavisë, që nga fundi i viteve '40, pra që nga prishja e marrëdhënieve midis dy shteteve dhe deri në gjysmën e parë të viteve '80. Përcaktimi i autorit për të bërë një libër për këtë periudhë mund të jetë varur nga dokumentet që ka pasur mundësi t'i marrë në shqyrtim, ose është prirë edhe nga ideja se kjo periudhë, historikisht e paeksploruar, krijon kuadër të mirë për të nxjerrë në sipërfaqe zhvillime shumë interesante dhe politikisht kontradiktore në marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës. Ndonëse dokumentet arkivore, mbi të cilat ndërtohet ky rrëfim, nuk janë as të Enver Hoxhës, as të Komitetit Qendror, autori nuk ngurron që me titullin e librit ta orientojë lexuesin në një konstatim apriori të pakontestueshëm: Enver Hoxha ishte vetë Shqipëria dhe se politikat e saj ndaj Kosovës nuk mund të ishin gjë tjetër, pos politika të vetë kreut të partisë dhe të shtetit shqiptar.

Por do vënë re menjëherë se këto politika janë ndërtuar në mbështetje të një informacioni jashtëzakonisht të varfër dhe shumë herë të gabuar që kishte Shqipëria për Kosovën. Më shumë më pëlqen të besoj se Ministria e Jashtme e Shqipërisë, ku u arkivuan këto dokumente, nuk duket të ketë qenë ndonjë qendër e rëndësishme e bërjes së politikës së shtetit shqiptar ndaj Kosovës. Megjithatë Shqipëria ishte shtet komunist diktatorial dhe meqë institucionet e saj shtetërore ishin të politizuara dhe thellësisht partiake, është më e besueshme se në bërjen e politikave të Shqipërisë ndaj Kosovës kjo ministri ishte një ekspoziturë e parëndësishme e partisë dhe e sigurimit të shtetit. Ndryshe, është vështirë të besohet se Shqipëria, në dritën e këtyre dokumenteve, paraqitet aq varfërisht dhe aq keq e informuar për Kosovën. Pavarësisht nga kjo rrethanë, unë vlerësoj librin e Esat Myftarit, sepse të gjithëve na e bën më dije se tashmë ka ardhur koha që rrëfimet tona për ndodhi të ndryshme historike duhet t'i mbështesim në dokumente, çfarëdo që të jenë ato. Dua të hap këtu një parantezë dhe të them se njëri prej zhgënjimeve të mia me studimet tona historike, është djentia se në Arkivin Qendror të Shqipërisë, që pesë-gjashtë dekada dërgjet një kopje e palexuar e shënimeve të mbajtura gjatë luftës të Miladin Popoviçit, në një kohë që kemi aq shumë rrëfime të tymta për LNÇ në Shqipëri dhe për marrëdhëniet



Kosova e Enver Hoxha

Mbi keqkuptimet e përsëritura historike Kosovë-Shqipëri

Një libër i botuar së fundi (Esat Myftari, "Kosova dhe Enver Hoxha", Tiranë 2016), që dëshmon se ekzistojnë dallime të mëdha ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë edhe në perceptimet e historisë më të re

e saj me kreun politik dhe ushtarak të Jugosllavisë. Dhe po bëhen 5 vjet të tjera që është bërë publik ky fakt dhe ende nuk kemi një përpjekje fillestare të ndonjë historiani, për të hedhur dritë mbi këtë pjesë të errët të historisë sonë. Pra, dua të them se, pavarësisht se Ministria e Jashtme e Shqipërisë nuk ka qenë vendi ku janë bërë "politikë dhe mëdha" të Shqipërisë për Kosovën, dokumentet e prezantuara në këtë libër, edhe nëse nuk japin tablo të plotë të situatës, japin indikacione të mjaftueshme për zhvillimet në marrëdhëniet Kosovë-Shqipëri, në një kohë me shumë enigma dhe paqartësi.


Por duhet ta themi këtu pa ekuivok, se edhe tani ekzistojnë dallime të mëdha nga mënyra sesi shikohen këto zhvillime, nga këndvështrimi i Kosovës dhe nga këndvështrimi i Shqipërisë. Esat Myftari, duke qenë "kosovar i Shqipërisë", është përpjekur që në

analizat e tij t'i sheshojë ose t'i tejkalojë këto divergjenca, kryesisht duke u mëshuar fort disa tezave, ose duke i shfrytëzuar disa njohje, të cilat u mungojnë analistëve dhe historianëve të Shqipërisë. Por, edhe pas leximit të këtij libri, do të shohim se ende mbesin shumë divergjenca dhe dilema të hapura. Këto divergjenca nuk mund të jalohehen vetëm duke stigmatizuar ideologjinë dhe diktaturën, siç bëjnë në përgjithësi autorët e Shqipërisë, në njërin anë, apo duke e ruajtur të paprekur sentimentin nacionalist, siç bëjnë kosovarët, në anën tjetër. Esat Myftari sjell argumente të reja për t'i stigmatizuar politikën e Shqipërisë ndaj Kosovës, por një numër syresh sërish mund të arkivohen si "lëndë për stigmatizim", në një kohë që pyetet e shumta, ende pa përgjigje, i tejkalojnë këto klishe dhe këtë stampë. Autorët e Shqipërisë janë të mollsur nga hija e errët e diktaturës, por edhe

nga djentia se Kosova mund të ishte një shtegdalje e tyre nga ajo natë e stërzgatur. Ndërsa mendoj se duhet thënë qartë: Kosova dhe Shqipëria ishin peng të vetvetes për një kohë të gjatë, dhe ishin peng të njëra-tjetrës për një kohë po aq të gjatë. Kosova nuk e zgjidhte dot problemin e brendshëm të Shqipërisë, nuk kishte potencial, nuk kishte forcë, nuk kishte kapacitete siç thuhet ndryshe, sikundër që Shqipëria nuk kishte kapacitete reale për të zgjidhur problemin e Kosovës. Prandaj, në një rrethanë të kësaj, do të jetë shumë e vështirë të bëhet një diferencim i qartë, që të kuptohet se cili ishte vërtet interesi shtetëror i Shqipërisë dhe çfarë ngatërronte në këtë pikë ideologjia, diktatura dhe lufta për pushtet, sikundër që është shumë e vështirë të diferencohet qartë, nga këndvështrimi kosovar, nëse ndryshimi i sistemit në Shqipëri, apo reformimi i tij ishte interes real i Kosovës, apo i politikave të ish-Jugosllavisë.

Pra, cili ishte interesi i Shqipërisë në Kosovë në kohën e Enver Hoxhës? Sipas dokumenteve që prezanton Esat Myftari dhe anali-





zave të tij, del se Shqipëria në Kosovë kërkonte të drejta të shqiptarëve në kuadër të sistemit jugosllav dhe, që ishte më me rëndësi, të mbante nën kontroll nacionalizmin e kosovarëve dhe lëvizjet e tyre separatiste. Ky interes i Shqipërisë (ende nuk e dimë në ishte interes shtetëror apo trill ideologjik i diktaturës), sipas analizave të Esat Myftarit, arrin pikë të larta, sa që Shqipëria të mos i mbështesë realisht demonstratat e vitit 1981 dhe të japë një miratim të heshtur për eliminimin politik dhe fizik të Jusuf Gërvallës. Në këtë pikë po i marrim të mirëqenë argumentet e autorit. Por ekziston edhe ana tjetër e medaljes: Çfarë synonte ish-Jugosllavia në Shqipëri dhe çfarë synonin eksponentët kosovarë të politikës jugosllave, të cilët janë të apostrofuara gjerësisht në dokumente, si Facil Hoxha dhe Mahmut Bakalli? Dhe çfarë synonin eksponentët intelektualë, përsëri kosovarë, të kësaj politike, fjalët e të cilëve merren pa rezervë dhe në mbështetje të fjalëve të tyre krijohen shumë mitologji? Nga këndvështrimi i sotëm, pra, pse u dashka t'i besojmë më shumë Facil Hoxhës se Enver Hoxhës, kur që të dy janë të proveniensës komuniste, në një kohë që njëri bënte politikë e shtetit shqiptar, pavarësisht se çfarë ishin ato, ndërsa tjetri bënte politikë e një shteti armik të Shqipërisë? Pse duhet të mos i besojmë Enver Hoxhës, kur thoshte

se Kosovën e kishte fort për zemër, dhe t'i besojmë Facil Hoxhës kur thoshte se janë në interes të Jugosllavisë marrëdhëniet miqësore midis dy vendeve, apo gjeputa të këtitlla? Në kontekstin e zhvillimeve të asaj periudhe, duhet t'i kemi të qarta dy gjëra: Për shkak të Kosovës, Jugosllavia synonte ta mbante Shqipërinë jashtë ndikimeve blokiste, veçmas jashtë Traktatit të Varshavës. Po për shkak të Kosovës (pra jo për interes të shqiptarëve të Shqipërisë, as të shqiptarëve të Kosovës), Jugosllavia synonte ta ndryshonte sistemin politik në Shqipëri, në mënyrë që ta kthente Shqipërinë në "përqafim vëllazëror", siç e kishte pasur dikur dhe ta pacifizonte Kosovën, ashtu siç e kishte paqësuar deri në vitin 1948. Se ishte kështu, do t'ju sjell dy fakte: Në tetor të vitit 1970, pas vizitës në Tiranë në kuadër të një delegacioni të Universitetit të Prishtinës, Mahmut Bakalli i bën një raport fort të hollësishtëm kryetarit të atëhershëm të Komitetit Krahinor, Veli Devës, në të cilin vendin kryesor nuk e zënë marrëdhëniet ndërmjet dy universiteteve, as marrëveshja e arritur, por gjendja politike në Shqipëri, me analizën e kujdesshme se si mund të ndry-

shojë politik Sipas Mahmut Bakallit, sistemi politik në Shqipëri do të ndryshojë nën tryninë e një shtrese të re teknokratësh, të cilët kishin filluar të shfaqnin hapur pakënaqësinë e tyre me prapambetjen ekonomike. Ngjebëdhjetë vjet më vonë, njëri nga eksponentët e politikës kosovare dhe përgjegjës për marrëdhëniet kulturore Kosovë-Shqipëri, Shaban Hyseni, ish-kryeredaktor i Radio-Prishtinës dhe bashkëpunëtor i afërt i Mahmut Bakallit, në qershor të vitit 1981, në mbledhjen e Komitetit Krahinor ku u analizuan shkaqet e demonstratave të marsit dhe prillit të atij viti, tha shprehimisht: Ne kemi shkuar në Shqipëri që t'i ndryshojmë ata, jo që ata të na ndryshojnë neve.

Sikundër e dëshmon edhe libri i Esat Myftarit, marrëdhëniet Kosovë-Shqipëri në këtë periudhë kalojnë përmes një sërë problemesh politike, strategjish, komplotesh, djallëzish dhe keqkuptimesh, duke

kundërvësh programit letrar të "Vox clamantis in deserto" me një tekst të Nebil Durakut, sikundër që nuk është shumë e përshtatshme të vendosësh në të njëjtën radhë Rexhep Qosën dhe Vehap Shitën, siç bën Shuteriqi në një raport të tij. Ose t'i japësh rëndësi politike dhe të zërë vend në relacione të "politikave të mëdha" për Kosovën një letër, që, citoj: "akademiku kosovar, Shaqir Jakupi" i ka dërguar kancelarit austriak Krajski etj., kur një "akademik" me këtë emër fare lehtë mund të ishte ndonjë mësues-gas-tarbatjer dhe pjesëtar i ndonjë organizate ilegale në Perëndim, i afërt me përfaqësitë diplomatike të Shqipërisë.

Në këtë tymnajtë të madhe mjegullash të marrëdhënieve të komplikuara ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë dhe në këtë mozaik gri, Esat Myftari vë një gur të rëndësishëm, i cili mbyll një segment dhe hedh dritë mbi një burim të informacionit të institucioneve të Shqipërisë për Kosovën, atë të Ministrisë së Jashtme. Nëse ky institucion ishte i rëndësishëm ose jo, është çështje jetë, por që duhet të plotësohet ky mozaik, për këtë nuk kam asnjë dilemë.

Së fundi, dy fjalë për gjuhën. Esat Myftari e shkruan librin e tij në gegërishten e standardizuar me bazë elbasanishten e viteve '60, e cila u përdor edhe në Kosovë deri në Konsullat Gjuhësore të Prishtinës më 1968, kur u vendos që Kosova përfundimisht të ndjekë Shqipërinë në punën e gjuhës. As këtë vendim Kosova nuk e mori vetë, por me miratimin e kreut më të lartë të shtetit jugosllav. Se ishte kështu, e dëshmon fakti se miratimin për të marrë pjesë kosovarët në Kongresin e Drejtshkrimorit e kishte dhënë Petar Stamboliqi, njëra nga figurat më antishqiptare të kreut politik të Serbisë. Në këtë rast, pra në rastin e gjuhës, që Kosova të ndjekë Shqipërinë, interesat e të tri palëve janë përpjethur çuditërisht: interesat e Shqipërisë, të Kosovës dhe të Serbisë, pra të ish-Jugosllavisë. Asnjëra nga këto palë nuk ishin të interesuara që nga kosovarët të bënin një komb më vete, secila për interesa të veta specifike. Mbi të gjitha, Serbia dhe ish-Jugosllavia nuk ishte e interesuar që nga Kosova të bënte një Maqedoni të re dhe një komb të ri, të ngjashëm me kombin maqedon, për një arsye të vetme, se me këtë veprim Serbia duhej t'i njihje Kosovës të drejtën e vetëvendosjes. Por pavarësisht nga kjo rrethanë, Kosova e mbështeti fuqishëm unifikimin e gjuhës standarde, gjithashtu për interesa të veta, e theksoj: për interesa të veta! politike, arsimore, kulturore dhe kombëtare, pavarësisht nëse kjo mund të mos i pëlqente Gëgnisë brenda Shqipërisë. Prandaj, shkrimi gëgnisht i Esat Myftarit më pëlqen për një arsye: neve të gjenatës më të vjetër na kthen në një kohë të largët dhe na bën pak nostalgjikë, ashtu siç bëhemi nostalgjikë edhe kur i sjellim në kujtesë ngjarjet e kësaj kohe të shkuar. Pra, ngjarjet dhe gjuha në këtë libër çuditërisht i shkojnë njëra-tjetrës.

përfshirë në vorbullën e tyre edhe emra të përveçëm të Kosovës dhe të Shqipërisë. Dhe gjithë analistët e Shqipërisë të këtyre marrëdhënieve duket se e kanë të vështirë të mbajnë një qëndrim të drejtë në raport me këta emra të përveçëm të Kosovës, sepse një numër syresh në Kosovë njiheshin si eksponentë të politikës dhe të shtetit jugosllav, ndërsa të adaptosh pikëpamjet e Enverit dhe të Partisë se kosovarët ishin revizionistë, pra edhe armiq të Shqipërisë, nuk del shumë e përshtatshme. Këta burra me emër nga Kosova shpesh ishin kolonë e pestë e Jugosllavisë, por kur këtë e thoshte Enveri dhe ta pranosh këtë si mirëqenë, të duket sikur po i bën një shërbim ideologjiksë së tij. Në të vërtetë, në shumë raste Enveri kishte të drejtë.

Më anë tjetër, do vënë re me këtë rast, se informatat që merr Ministria e Jashtme e Shqipërisë rreth Kosovës nuk janë cilësore dhe prandaj nuk duhet të shprehim habi për qëndrimet politike ndonjëherë krejtësisht të gabuara rreth Kosovës dhe shqiptarëve në ish-Jugosllavi. Kështu ndodh edhe me emrat e përveçëm. T'i numërojmë disa raste: Kosovarët nuk mbajtën qëndrim të rezervuar ndaj historianit dhe orientalistit Hasan Kaleshi, pse ai iu kundërvu pikëpamjeve të Aleks Budës, por për shkak se tezat e tij për pushtimin osman, për islamizimin dhe për Skënderbeun ishin teza të historiografisë serbe dhe turke. Më anë tjetër, është e padenjë që ta ndërtosh pikëpamjen e kosovarëve për Kongresin e Drejtshkrimorit duke u mbështetur në një tekst të Hasan Kelmendit, eksponent politik dhe gjuhësor i Halit Tërnavcit. Apo t'i

PORTRET | ARTISTI

NGA XHAHID BUSHATI

Kolë Shiroka u lind më 16 gusht të vitit 1900 në Shkodër. Rridhte nga një familje e vjetër peshkatarësh. (Siç duket mbiemrin e ka marrë nga vendi ku ka jetuar, në Shirokë). Ishte djalë i vetëm mes tri motrave. Edhe pse i tillë, ndërkohë që i ati Lushi dhe e ëma Silja e shikonin si sytë e ballit, në moshën 13-vjeçare ai merr rrugët e dhimbshme të mërgimit. I merr ato rrugë, duke lënë pas si një peizazh të trishtuar fëmijërinë dhe plot ëndrra lundrimi me varkë... Do të punojë shërbëtor e berber nëpër dyert e shtëpive të Cetinës, në Mal të Zi, deri në vitin 1918.

Rrugët e mërgimit do ta sillnin përsëri në vendlindje. Tani i nënshtrohet profesionit të berberit, ndonëse nuk e ka me qejf. Kështu, hap një dyqan në lagjen Gjuhadol. Dyqani, nis si pakuptuar, të kthehet në studio e në klub ahengxhinjsh. Kola nis të pikturojë e, së bashku me disa shokë, formon edhe një orkestrë. Gjithashtu, ai do të jetë i pranishëm edhe si instrumentist në Kafe të Madhe, duke i rënë xhezit e duke shoqëruar profesorin italian Muçi, që i binte pianofortës. Peneli i piktorit Kolë Shiroka la ca peizazhe nga Shkodra, portrete të ndryshme e deri reklama tregtie. Allçia e skulptorit Kolë Shiroka na la të skalitur një grua, e cila mbante një shtambë për të mbushur ujë te truma e Dugajve të reja. Të vjen keq që kjo vepër u shkatërrua dhe humbi përgjithnjë. Sidoqoftë gjurmët e talentit të Shirokës i shikon ende sot. Dëshmitar i heshtur është tavani i ndërtesës së Prefekturës së Shkodrës. Në katër cepat e saj janë punuar me allç katër shqipe.

Kola, në orkestrën që do të formojë, do të jetë bashkë me Kolë Lufin e Kolë Vjerdhën. Tre Kolat... së bashku me të njëjtin emër, ishte thjesht një rastësi. Përveç kitarës, Kola do t'i bjerë edhe violinës, mandolinës, braçit, etj. Me vonë, me disa miq të tij (zanatçinj, nëpunës, mësues e punëtorë të talentuar), si: Simon (Gurakuqi) Rranxi e Shuk Paloka këpucarë, Cin Nush Daija marangoz, Gjon Laca rrobaqepës, Luigj Dajçi mekanik, Ton Daja berber, mësuesi Kolë Kosmaçi, nëpunësit Kel Luka e Gegë Gurakuqi etj, formojnë shoqërinë "Rozafat" (brenda kësaj krijuan grupin "argtimuer"), më 13 shkurt 1918, e cila vijoi veprimtarinë e vet për rreth 20 vjet. (Kryetari i parë i saj u zgjodh Kel Luka, nënkryetar, Simon Gurakuqi (Rranxi), këshilltar Cin Daija. Anëtarë të tjerë të kryesisë ishin Luigj Daja, Gjon Laca, Shuk Paloka.)

Për këtë shoqëri, aktori veteran Gjon Karma, në kujtimet e tij, ka thënë: "... Rozafati ishte e vetmja shoqëri në Shkodër, ku anëtarët e saj mbledheshin me familje, burra, gra, vajza dhe kalonin mbrëmjet



► Kolë Shiroka

Kolë Shiroka, mjeshtri i madh i karnavaleve

"Dialogu" i Kolë Shirokës me karnavalet, përmes viteve 1931, 1932, 1934, 1936, e ai që s'doli më 1937; ka shumë peripeci, histori e ngjarje të këndshme e të pakëndshme, gëzime e zhgënjime, censurë dhe tentativë për burgosje...

me bufetë dhe kërcime moderne e valle popullore, recitime dhe fjalë gazi, etj. ... Kolë Shiroka ishte vjershëtar, scenografi e aktori i grupit. Ka interpretuar në lojërat e gazit "Dy të fejuem në një burg", "Serreti", "Lejleku në Shirokë", në komeditë "Njeri me hanë", "Batakçia", në dramën "I mërguem", "Vdekja e Skënderbeut".

Talenti i Kolë Shirokës preku shumë gjini të artit, por veçanërisht ai shkëlqeu dhe u bë personazh me karnavalet, që Shkodra i kishte traditë.

"Dialogu" i Kolë Shirokës me karnavalet, përmes viteve 1931, 1932, 1934, 1936, e ai që s'doli më 1937; ka shumë peripeci, histori e ngjarje të këndshme e të pakëndshme, gëzime e zhgënjime, cen-

surë dhe tentativë për burgosje...

Duke njohur historikun e karnavaleve, mësojmë se ata përgjithësisht bëheshin me maska të përpunuara e me kostume të vjetra. Gjithsesi kjo iniciativë ishte e mirë, por tingëllonte disi anaronike për kohën. Hyrja e Kolës në këtë hulli interesante humoristiko-satirike benë që karnavali, në një masë të konsiderueshme, t'i ndërrohej fytyra duke i vënë "maskë" të re mendimi, problematike e humorit. Ai luftoi dhe e konceptoi karnavalin më folës, më shprehës i nevojave e hallëve të njerëzve e me një ngjirim sa më të kohës. Aq sa për disa vjet rresht doli i vetëm para publikut shkodran...

Në vitin 1931 Kolë Shiroka for-

moi një grup, shumicën e të cilit e përbënin anëtarët e shoqërisë "Rozafat". Ky grup doli rrugëve me karro alegorike që mbarte një flutur të madhe, në krahët e saj dukeshin maskat e pikturuara të anëtarëve të grupit.

Në vitin 1932 Shiroka me grupin e tij u veshën bukur me robe moderne dhe kaluan rrugës së qytetit hipur mbi një vabor të madh, duke iu rënë veglave muzikore e duke deklamuar bejte që trajtonin krizën e papunësisë.

Në vitin 1934 grupi i Kolë Shirokës u shpërnda se kishte rënë në sy të qeverisë për kritikën ndaj saj. Kësaj radhe Kola u maskua dhe doli vetëm. Bëri një karro simbolike, mbi të cilën vuri globin e tokës. Vetë u vesh si astronom. Me anën e

bejteve trajtonte problemin e krizës që kishte mbërthyer botën e njëkohësisht kritikonte kumarshtinjtë, alkoolistët, dembelët, kapadainjtë, femnistët, etj. , që ishin shndërruar në fenomene shqetësues për qytetin.

Në shkurt të vitit 1936, Kolë Shiroka kurorëzoi apogjeun e karnavallit shkodran. Me fantazinë e tij vuri mbi karro, ditën e karnavaleve, një lopë të dobësuar kockë e lëkurë, gjinjitë e së cilës i thithnin me radhë ministrat e asaj kohe. Bejtja e thurur me këtë rast demaskonte me humor e sarkazëm punën e ministrave. Mjafton të përmendim këto vargje:

Mirë e dini ju shkodranë, se der m'sot kurrqja s'm'ka pshtue,

as për dhimbë ndoj send s'kam
lanë
pak a shumë pa kritikue

Shumë kuj desha me ja ngopë,
por mjerisht nuk kje e shkrueme,

paçë mendue me ba këtë lopë
me Ministra t'koh's s'kalueme.

Lopë mbetë në asht e lëkurë,
paraqet popullin Shqiptar
i cili ka kenë dikur
fund e majë i veshun n'ar.

E njaj ar qi ka pasë veshë
kaj mendoni se ka shkue?
njikta hajna ja kanë zdeshtë
e ndër banka e kanë çue.

S'ka njoftë ligje as rregullore
ka qenë raje çdo zyrtar
ma randësi ka pas një horre
se ma i nderti qytetar.
Në e paç pasun ndoj kushëri
ministër a deputet
ke pas të drejtë për nëpunësi
pa ditë të shkruajë emnin e vet.

Dhe 34 strofat e këtij karnavali,
përfundojnë me një humor paksa
tragjik nga bejtexhi Shiroka, i cili
thotë: "T'gjithëve mbarë tue iu
përsëndetë? Pleq e t'ri sido qit
jeni/ po tham, si sot nji vjetë/ për
në m'pafshi qar e keni..."

Kola nuk doli më në publik. Dhe
është e kuptueshme... Gjatë vitit
1936, ai kishte grumbulluar mëllëfin
e madh për ta shfryrë e për ta pa-
raqitur me realizëm, nota humori e
sarkazme në karnavalin e vitit 1937.
Kola përgatiti tufëzën: "Karneval,
mos e lsho vedin". Mjerisht ato
bejte mbetën në sirtarin e tij... Nga
që përgjithësisht, vargjet e këtyre
bejteve janë të panjohura, po ju
njohim me disa nga strofat e tij:

...
T'kam pasë thanë se n'vëndin
tonë
Kurrmi send nuk ecë për
s'mbarit,
Askerkuej s'i bahet vonë
Edhe n'pasët Kombi i Shqyphtarit.

Pse na pvetë se "ku po vemi?"
Tue na pa n'këtë farë mjerimit,
Kah kërkojmë atë që nuk kemi:
Liri fjalët e mendimit?

Jeni plakë, keni mbarue
E këtë fjalë pa frikë e thona,
Rinisë postet me ia lshue,
Se Shqyprija asht e jona...

Me strofat që pasojnë, autori i
këtyre bejteve interesante e plot
magji humori çon kushtrimin:
Çoju, pra, popull i shkretë,
T'drejtën tande me kërku
Mos rri strukë e mos rri fjetë
Për në daç ti me shpëtue!

Ma mos t'kapna për dyer tm-
dhaja,
Por t'ia ndijmë fjal't çerekësisë,
Vetëm kshtu na mban uzdaja



► Kolë Shiroka

Me ia pa tyrën lirisë.
Por... nga këto kritika të rënda
në adresë të qeverisë, Kola pësoi
shumë telashe, të cilat i kapërceu
me shumë vështirësi. Ai u dënuar
që të mos dilte kurrë më në kar-
navalet përgjatë tërë jetës së tij.
Kremtimi i karnavaleve vazhdoi
edhe për disa vite. Pushoi së qeni
në vitin 1939.

Që nga ky vit e deri më 1944,
në rrugët e Shkodrës nuk u dukën
surretnit e karnavaleve. Nëpër
vite-karnavalesh Kola doli herë
me maskë kuçedre, herë me
maskë triumfi, herë mbi karron që
e meremetonte vetë me kujdes e
gjithë humor, ku do të recitonte
bejtet. Karnavalin e Kolë Shirokës
nuk e panë me sy të mirë au-
toritetet e kohës. Po t'i shikosh sot
pjesët e mbetura dhe të arkivuara
nga familja, shumë strofa janë të
ngjyera me të zeza. Ajo ngjyrë
e zezë e keqdashëse nuk ishte e
zonja të rezistonte, sepse shumë
strofa gjithë humor kapërcyen vitet
dhe erdhën qart në kohën tonë,
e na flasin gjerë që gazmoret e Kolë

**Lindi më
16 gusht të
vitit 1900
në Shkodër.
Rridhte nga një
familje e vjetër
peshkatarësh.
Siç duket
mbiemrin e ka
marrë nga vendi
ku ka jetuar, në
Shirokë**

Shirokës sfiduan anakronizmin e
kohës e censurën e asaj kohe...

Kolë Shiroka vdiq më 14.10.
1984 në Shkodër, në moshën 84
vjeçare. Ai na la vargje humori që
s'harrohen lehtë nëpërmjet udhë-
timeve të karnavali.

Çuditërisht ky njeri që
jetën e tij e lidhi me karnavalin,
që, sikur s'u mjaftua me këtë sofrë
të begatë humoristike; si një ku-
jtim lirik shkroi librin: "Lamtumirë,
djalëri!" (Shtypshkronja "Nikaj",
Tiranë, 1932). Krahas poezive hu-
moristike të tipit karnavalesk që
autori i kishte për merak dhe për
zemër, përfshihen dhe një tubëz
lirika me shfrime e përmallime, me
ëndrra e zhgjandrra, dëshirime e
pendime djaloresh "të kohës që
ikën e nuk vjen më", me kujtime
nostalgjike e deri diku edhe në
shfaqjen e ndonjë reje pesimizmi
të pranuar dhe të përligjur, dialogët
idilike me vashën, ku elementët e
përshkrimit të natyrës 'intonohen'
në gjendjen shpirtërore të person-
azheve, etj., - të gjitha këto flasin se
Kolë Shiroka ishte dhe një poet lirik,

e brumi i poezive, figurat, kadenca,
etj. gjejnë refleksë të motiveve e
këngëve popullore shkodrane, të
cilat mendoj, që autori Shiroka i
njihte mirë.

Pa durim pres t'agojnë drita
Rrexet diellit me ja pa
Kjëçë i ri e s'mund u prita
Ty i dashtun pa t'u ba.

N'kohë ma t'bukren ti m'harrove
Thue s'jam njajë qi kjëçë dikuer
Dashtunin nuk e kujtove
Mos u ban kaq zember guer.
(poezi: Mos u ban kaq zember
guer, f.18)

Edhe sot, shkodranët kujtojnë
vargje të shumta nga krijimtaria e
autorit Kolë Shiroka. Teksa i kujto-
jnë, në fytyrat e tyre i ravijëzohet
buzëqeshja... S'mund ta kuptojnë
emrin e komikut Kolë Shiroka pa
humor e buzëqeshje. Dhe kanë të
drejtë... se jetojnë në kohë humori
i tij brilant dhe lirizmi i shpirtit...

Shkodër
nëntor – dhjetor 2016

POETI | LIRIK

NGA ALI ALIU

Që në fillim të fjalës sime dua të theksoj posaçërisht se poezia e Shaip Beqirit zë vend ndër më të merituarat në letërsinë shqipe. Që ajo nuk ka qenë në këtë shkallë të vëmendjes, arsyet kryesisht duhet kërkuar edhe në rrethanat e veçanta: ngjarjet dramatike nëpër të cilat kalonte Kosova në fund të shekullit të kaluar, por edhe në fillim-shekullin e ri e zhvendosen letërsinë dhe kulturën përgjithësisht në periferi të vëmendjes. Në këtë kontekst, edhe migrimi i poetit Shaip Beqiri nga Kosova për më shumë se 20 vite, e ka bërë të vështirë komunikimin, e në fushën e krijimtarisë letrare sidomos.


Megjithatë, për këtë mosvëmendje të pamerituar "fajin" e ka edhe vetë Shaip Beqiri, përkatësisht natyra krijuese e tij; për afër pesëdhjetë vite krijimtarie, deri më sot ai botoi vetëm katër libra 'themelorë', siç i quan vetë. Tiparet kryesore që e shquajnë këtë natyrë krijuese janë: para së gjithash përgjegjësia maksimale ndaj fjalës poetike dhe kursimtaria fanatike e saj para se të nxirret për lexuesin...

Vargjet e para, si gjimnazist, Shaip Beqiri i botoi që në fillim të viteve 70-të dhe librin e parë "Fontana e etjeve" më 1976. Kurse sivjet, në 40-vjetorin e botimit të librit të parë, solli librin e pestë "Hinoret e njëjta", që është përzgjedhje nga librat e mëparshëm si edhe vargje të pabotuara deri më sot. Në këtë kalendar poetik të tij, bie në sy edhe një detaj karakteristik që e ilustron natyrën krijuese të këtij poeti: Shaip Beqiri dorëshkrimin e librit të parë e dorëzoi për botim të Rilindja më 1974, kur ishte njëzet vjeç. Por, para se të merrte përgjigjen e recensentëve, ai e tërhoqi dorëshkrimin, për ta rishikuar edhe një herë... Dhe ky rishikim i zgjat plot 2 vjet. Kështu, "Fontana e etjeve", libri i tij i parë, u botua me dy vite vonë, sipas kërkesës së vetë autorit.

Një përgjegjësi prej fanatiku ndaj punës, ndaj veprës së vet krijuese, e përcjell gjatë tërë jetës këtë poet, i cili sjell ndërmend poetë e shkrimtarë të mëdhenj që mbërritën majat e artit me sasi vëllimore modeste, siç është rasti në letërsinë tonë me Besim Bokshin.

Është thënë që Shaip Beqiri për afër 50 vjet shkruan një të vetmin libër poetik. Mendim që qëndron për shumë shkrimtarë: pas leximit të katër librave – përkatësisht pesë, lexuesi natyrisht ka këtë përshtypje... Në vazhdim të kësaj mbrese, imazhi në ecje i ngjasjes bosht të muzës poetike të Shaip Beqirit: zënia e parë, artikulumit poetik me veprën "Fontana e etjeve" vjen si një riosh i këndshëm, plot shëndet dhe energji të brendshme, që kërkon hapësirë edhe më të madhe për t'u shtrirë përtej kufijve, që është i gatshëm për akrobacione dhe sfida përballë një bote – në çaste të frikshme, apokaliptike, bote që mund të duket si e mbërthyer brenda nufullave gjigande prej përbindëshi që vjellin zjarr e gjarpërinj...

Dhe kështu në ecje, nga libri në libër, ky riosh zbutet, urtohet, artikulolet në një mendimtar me lëvizje gracioze estetike, që sjellin art poetik ku bashkohen në harmoni emocioni, imagjinata, nën prirjen e refleksit të racios. Poezia e Shaip Beqirit që nga fillimi e sjell një disponim të ngrysur – pa ngjyra optimiste... Ishin të tilla, të trazuar, ngarkuar shqetësimit dhe brengë që në zënie, në fillim të viteve 70-të, me librin e parë "Fontana e



SHAIP BEQIRI

Liriku i shquar i brezit të vet

Për afër pesëdhjetë vite krijimtarie, deri më sot ai botoi vetëm katër libra 'themelorë', siç i quan vetë. Tiparet kryesore që e shquajnë këtë natyrë krijuese janë: para së gjithash përgjegjësia maksimale ndaj fjalës poetike dhe kursimtaria fanatike e saj para se të nxirret për lexuesin...

etjeve". Burim i parë i frymëzimit të tillë ishte perceptimi i poetit gjimnazist i realitetit të etnisë së vet në Kosovën e tij, realitet që dukej i pashpresë nën çizmen serbe. Që këndeje edhe imazhet me ngarkesë apokaliptike, që shpërthejnë herë-herë në vargjet e këtij vëllimi të parë poetik... Dhe për çudi – të paktën në shkrimet e botuara për të aso kohe, nuk hetohet, nuk përmendet fare, për të mos thënë hesitet ky burim dëshpërimi... E dashuria për vendin, ndërsa shqetësimi, sado diskret, është dramatik dhe fare i lexueshëm, që në hapat e parë, përfshirë këtu vargjet e librit "Fontana e etjeve". Le të sjellim vetëm disa nga shembujt e shumtë me këtë rast:

Agimi po zgjohet nga ëndrra e barit
Me gjunj të përgjakur
Toka ime

Në kullën e mbyllur të ëndrrave
Sa e gjatë qënka nata jote
Ku pushkën përqafoj si vashën e shpëtimit
Deri të zgjohet agimi me gjunj të përgjakur


(Agimi me gjunj të përgjakur)

Është arterie e fuqishme frymëzimi etnia dhe Kosova në fillimet e para poetike të Shaip Beqirit. Pikërisht ky ngasës e bën lirikën e tij përsiatëse, e stimulon imagjinatën drejt imazheve dhe figurës poetike që njëkohësisht i krijon mbulesë prej 'syrit kujdestar' të kohës. Natyra e tij poetike, me prirje refleksive për përsiatje mbi ekzistencën, qenien, dhe vizionin drejt brigjeve metafizike, me kohë do të shndërrohet shenjë njohëse kryesore në opusin krijues të tij. Tërë shtjella dramatike nga përditshmëria, tërë fluidi ngrysës në poezinë e tij, shpërfaq dhe reflekon dëshpërim konstant, kryesisht pa objektiv të qartë prejardhjeje. Poezia e tillë, prandaj nxit përsiatje drejt kërkimit të vetes, të kuptimit, të ekzistencës. Jo për efekte lamentimi por për ta mburur, për ta përgatitur veten drejt mirëkuptimit, faljes, që la parapëlqen natyra krijuese Shaip Beqirit. Labirinteve të tillë kalojnë dhe shpërthejnë në horizont, të ngarkuara dhe pleksura ngjyrimesh, refleksit poetike që përbëjnë univers të dallueshëm të këtij autori në poezinë shqipe. Rropatje sizifiane e poetit është kjo, e poezisë që e sfidon,

e mban zgjuar ngasjen e zërit lirik, rropatje e gjakim për ta përplotësuar boshin gërryes që qëndron kërcënues në vizionin dramatik të poetit, ngasje pa të cilën s'mundet poezia, ngasje mister që e ka munduar deri në klithje Hajdegerin: "Pse patjetër të kesh një gjë – pse jo asgjë?!" Rishtazi e përtëntur, filozofia e kësaj lirike anon drejt prirjes të jetë e qartë dhe në harmoni me thelbin e pagjetur të ekzistencës, me të cilin do të përballet pafundësisht...

Të gjitha vatrën e rrjedhave, stuhitë e zëna njoje më sipër dhe shumëfish të tjera vatra të brendshme, i turren qenies poet, i cili bëhet zë i tyre, qenie e tyre. Dhe padyshim zbulimet e hapave të parë në botën përreth, njohja me oborrin dhe vatrën, etninë e pranguar, do të lënë gjurmë të fortë në botën dhe vetëdijen e poetit, duke sjellë ngjyrimet betejash dhe disfatash tragjike ndër shekuj, realitet pa liri dhe kërcënim konstant, do të shfaqen sa të zëshme sa të heshtura në poezinë e Shaip Beqirit...

Me kohë, rrugës jetësore dhe krijuese ai do ta begatojë këtë univers të brendshëm me bëma dhe refleksë përditshmërie, gjatë



ballafaqimeve me sfida të shumta, me zatetjeh engjëjsh dhe me djaj që do të ndikojnë dhe formojnë natyrën, qenien e tij prej krijuesi, filozofinë, personin dhe personalitetin, perceptimin mbi botën, njeriun dhe zotin, me realitetin e këtejme dhe të andejme... Ecja jetësore, formimi krijues, kulturor dhe njerëzor këtyre udhëve, ka lënë ngjyrimet edhe si faza, etapa krijuese të dallueshme në krijimtarinë e poetit. Libri «Hinoret e njëjta», deri më sot, është arritje artistike kryesore në opusin letrar të Beqirit... Lidhur me këtë libër poetik të veçantë mund të përmenden disa prije, si ajo anagramore, shkolla lasgushiane, purpoezia... por unë, me këtë rast, do të përmend rikthimin e përhershëm të dialogut të zërit lirik me veten, sy më sy gjatë bilanceve jetësore, gjatë çasteve dhe situatave të ndryshme që prodhojnë rishtazi variante të shumta vargjesh dhe poezish.

Një veçori tjetër, për mua e dorës së parë, është gjuha poetike e Shaip Beqirit, gjuha që si genie e gjallë në krah të poetit i vihet në shërbim çdo lëvizjeje të emocionit, të imagjinatës, çdo nuance dhe ngjyrimi të tyre, përfshirë edhe disponimin gri të trazuar të shpirtit dhe mendjes... Duke iu përshtatur situatave të brendshme të botës poetike, ajo, gjuha, shpalos nga thellësitë e veta tërë potencën shprehëse, e përgatit, e programon veten – qoftë në shërbim të tingëllimit, të eufonisë, të ritmit, figurës, leksikut, imazhit, natyrës, gjithësisë, mittit, historisë...

Gjuha më bie pluhur përdhe
Sipër hijeve të mberthyer
Ndanë lumit nëntokësor
Që ulërin si tigri kur lëpin qiellin
Nder pasqyra të thërrmuara pezmi
(Muri)

Dhe në këtë shtjellë të brendshme dhe të jashtme krijuese, vijnë varg shpërthimit harmonike të sensacioneve vizuale dhe të

zëshme, pamje impulsive, vizione gjithësie, ekzaltime mistike dhe përjetësie. Poeti, ndërkaq i ofron gjuhës një hapësirë për të vendosur ëndrrën – magjia tërheqëse e së cilës është tmerrsisht e pushtetshme. Zëri lirik - i plotësuar pasi e prek, e vë në lëvizje rebeluese, e alarmon mendimin - dhe s'është në nisur nga e para – sidomos të vargjet e ciklit mbi veten, mbi unin, vargje ku ai shihet sy më sy me veten, bën bilancin, testamentet dhe kotësinë - dhe në fund sikur nuk shpreson më shumë se kaq – të niset nga e para... Në këtë udhëtim, shpesh dramatik por edhe

Vargjet e para, si gjimnazist, Shaip Beqiri i botoi që në fillim të viteve 70-të dhe librin e parë "Fontana e etjeve" më 1976.

rebelues në momente, Shaip Beqiri i bën për vete, i zbut, i vë në shërbim të artit poetik hiret e pamposhtura të gjuhës.

Dhe sidomos i veçantë del poeti Shaip Beqiri në vargjet e atdhedashurisë, madje qysh në hapat e parë, me gjuhë ezopike, larg patoseve dhe afishimeve populiste. Përshtypja se lirika atdhetare e Shaip Beqirit sikur ka mbetur në margjina të vëmendjes forcohet duke e lexuar librin e parë të poetit "Fontana e etjeve", të ngjizur në kërkim të trolit të vet, të shpirtit të tij. Nën trysinë e autocenzurës dhe imagjinatës së bujshme që vërshon me pamje përmasash apokaliptike, në gjirin e këtij frymëzimi, poeti do të artikulojë lirikën e atdhedashurisë me një gjuhë fare të re, të padëgjuar deri atëherë në poezinë shqipe, gjuhë që sot e gjithë ditën tingëllon e freskët.

Në ilustrim për këtë po sjellim vargjet e poezisë "Vetëtima e çapëlaur". Frymëzimi i poetit të ri, në fillim të viteve shtatëdhjetë e ka Kosovën, vendlindjen e tij dhe sjell imazhin virtual të trolit, sjell shqetësimin, vijillimin sogjetar mbi të. Le të veçojmë refleksat më afektuese që nxit imazhi tek poezia "Vetëtima çapëlaur" dhe lumi Drin. Vetëtima çatal (mbi qiellin Kosovë), mbulon si kërcënim visoret e shpirtit poetik, që dikush e quan atdhe e


dikush e ka brenda në vete... Është strofa që e hap poezinë dhe, në vijim, goditja vetëtime shndërrohet në imazhe kërcënuese përmasash të frikshme: gjarpër dykrerësh me nofulla që shtrëngon, vjell zjarr... Në strofat e pjesës së dytë të poezisë shfaqet Drini, me ç'rast poetit i shpërthen klithma-psherëtimë : O Drin, ind i pezmatuar që përshkon gjeografinë tonë të copëtuar - mbetur në gojë ujqsh... Edhe thirrjet në këtë poezi janë të kursyera, por Drinin dëshmitar, nuk ka si të mos e thërrasë në ndihmë: ...Dil prej zgavrave të tua dhe futu damarëve të këputur të dheut dhe atdheut që ndryn dhembjen, tërmet të ngujuar, ëndrrën dhe revoltën e shtypur...

Rrallë kush e ka sjellë kaq të fuqishëm dhe kaq drejtpërdrejt revoltën në lirikën patriotike të kohës dhe brezit të poetit Shaip Beqiri. Drini është lumi i trazuar i poetit: që në fillim, me vargjet e para, ai do ta ndiejë prekjen, dhuntinë e të qenit poet, siç ndjehet qartë i përcaktuar nga brenda për rrugën që do të ndjekë në jetë. I qartë se përgjatë kësaj rruge të zgjedhur do të përballet me vetëtima kërcënuese dhe gjarpërinj vallëzues...

Fjala e mbajtur në ceremoninë e dorëzimit të çmimit letrar "Beqir Musliu" poetit Shaip Beqiri, në Gjilan, Qershor 2016.

FESTIVALI | TEATRI

NGA MIHO GJINI



“Bota e teatrit” në skenën e Elbasanit

“2016 NEW ENERGY”, Festivali Ndërkombtar Konteporan i Teatrit, shpreh një vizion më të gjërë, me pjesmarrje nga disa shtete të botës, që nga Sh.B. A e deri në Izrael, me trupa teatrore nga Argjentina, Rumania, Italia, Suedia, Mali I Zi, Kosova, Maqedonia dhe të disa trupave të vendit mikpritës...

55 vjet më parë, kur u cel në Elbasan perdja e Teatrit Profesionalist të qytetit, përball kalas së lashtë dhe u shkrua tek dera emëri “SKAMPA”, pata fatin te emërohesha si regjisor e drejtor i këtij teatri, kur sapo kisha mbaruar shkollën e lartë të aktrimit dhe skena më ngjante se përmbledhte aty të gjithë botën. Por aq sa nuk numëroheshin gurët e kalasë, aq edhe nuk llogariteshin dot pjesët e repertorit që ky institucion të “ngrihej” e të lartohet deri në ditët e sotme, tek shohësh se tani janë mbledhur aty artistë të teatrit nga e tërë bota.

Jemi përpara një festivali teatrore krejt ndryshe, që qëndron larg të tjerave të këtij lloji, shumica e të cilëve kanë rrëshqitur në “kallëpe” formaliste, festival për festival dhe jo pak herë, nëpër duar të disa tipave pa horizont e zhatësisish ordiner te fondeve publike. I titulluar “2016 NEW ENERGY”, Festivali Ndërkombtar Konteporan i Teatrit, shpreh një vizion më të gjërë, me pjesmarrje nga disa shtete të botës, që nga Sh.B. A e deri në Izrael, me trupa teatrore nga Argjentina, Rumania, Italia, Suedia, Mali I Zi, Kosova, Maqedonia dhe të disa trupave të vendit mikpritës. Me qëllimin më të lartë që ofron ky institucion i lashtë e hyjnor, për edukimin e publikut, përmes teatrit, me vlerat e ballafaqimit të arritjeve bashkëkohëse te artit skenik, të dramaturgjisë dhe të kritikës, me eksperimentet dhe vizionet e këtij arti të magjishëm. Aty ishte i gjithë arsenalit interpretativ, që nga drama e monodrama, nga komedia humoristike e komedia e zeze, nga farsa e grotesku, nga teatri i femijeve dhe inskenimi i përrallës, nga vodevili, baleti dhe trioja instrumentale brilante e fisarmonikave. Duke përfunduar në artin vizual të spektakleve teatrore përmes videokasetave të shfaqura në monitor, nëpërmjet autoriteteve të shkencës teatrore nga teatrotë të shquar, sikundër ishin ato të studjuesit e regjisorit Roland Hill nga Ny Jorku dhe të pedagoges së Unevërsitetit të Telavivit Savit Cohan nga Izraeli. Dhe, po ti shtonim kësaj panorame të gjërë edhe ekspozitën e fotografisë artistike të mjeshtrit Saimir Ahmeti, përbrenda mureve të kalasë, kushdo do të bindej për modelimin e një festivali të nivelit evropian. Eshhtë pikërisht këndvështrimi i regjisorit Adonis Filipi që e bënte performancë krejt ndryshe e plotësisht të suksesshëm, ndaj së cilës nuk mund të kurseheshin fondet e gjithë atyre institucioneve shtetdore e private që e duan artin e përparimin e kombit, sikundër u cunguan tmerresisht në festivalin e tanishm! Qoftë edhe për arsyen e vetme të largimit përfundimisht nga ato paraqitje të rëndomta e amatorëske që i afrohen hera herës spektatorëve tanë, duke e ngushtuar kështu ca më tepër varferin shpirtëror, tok me problemet politike e partiake që përjetojmë.

Begatia e një festivali të tillë meriton një studim a seminar, si

arritje e përgjithesim eksperience teatrore. Trupat që përmendëm më lartë, kishin në krye të tyre personalitete të regjizurës, si edhe mbartnin viera të vërteta, eksperiencia e arritje bashkëkohore, që e vlejne te ndalesh , të diskutosh

aktorëve malazezë Danilo Babović, Bojana Malinovska, Milos Pejović e Srdan Dordević, jepet e gjithë fuqia e erotit, si një bashkim trupash që do të sjellë më pas lumturinë e jetës po edhe zhgënjimet e saj me pasoja vdekjepruresë.Përjetimi

e pastaj të të dashurit te saj.Po në jetën e përtejme , ku ata do të afrohen e dashurohen rishitazi, pa e njohur tashmë njeri-tjetrin, mullët e hedhura sheshit do të shkelen e thërmohen nën këmbët e në duart e tyre, duke dhënë kështu mesazhin



vdekjes, në ciklin vicioz të ekzistencës. E ndarë në tre pjesë dhe e vendosur në një skenografi sa funksionale aq edhe konvencionale, në të dy anët e shinave të trenit, ku në një interpretim të shkëlqyer prej

i dashurisë dhe i aktit seksual do të ndërpritet egërsisht nga një forcë djabolike e padukshme dhe efektive njëkohësisht, përmes një burri tjetër që do të ndërhyjë aty, duke “mbjellur vdekjen” e Evës fillimisht

fuqizohet si një protestë ndaj aktit terrorist në Klubin e Hebreve te Parisit, ku, ndonjë jo me tingëllimën artistike të aktorëve malazez, arrin të nënvizojë gjithësesi ritualin “përtej Zotit dhe djallit,

përtej hakmarrjes dhe faljes, për të rivendosur harmonin e humbur”. Po një ndjenjë edhe më të fortë dashurie sublime për jetën do ta shihnim në inskenimin e tregimit të Çehovit “I dashuri im”, ku aktorja Griselda Gambaro do të përcillte me dirnjtetein e një aktoreje-klasi, të gjithë gamën e jetës, në trajtën e një paraleleje, ku rëfëhet fati fatal i një gruaje ruse, që nuk mund të jetoj pa dashurin njerëzore, së cilës i vdesin të katër burrat që kan hyrë në jetën e saj. Thuajse e ngujuar, po me një shpirt të t pasur e qëndresë skenike të pazakontë, estetikiisht të lartë, ndonjë të dërmuar e të cillitur , ajo do të kërkoj deri në fund “Ivanin e saj”, duke qenë përherë e pangushëllueshme, derisa e tërë dashuria e saj e mbrame do të t përfundoj tek macja e shtëpisë! “Pa dashuri, nuk jam askushi”, thotë ajo në castet e këtij mjerimi njerëzor, kur tashmë poetika e jetës është përmbysur dhe e tërë jeta është e mbetet si një përrallë e vërtetë. Do të linin mbresë edhe disa spektakle të realizuara me art , si ajo e regjisores Jonida Beqo e Teatrit “Metropol” të Tiranës , në një vepër japoneze, “Rashoman”, ku po përmes veçorive specifike e stilit të këtij teatri, shprehet se si kantandiset një proces gjyqësor, kur e vërteta fshihet pareshtur në disa versione të dyshimta. Një varjacion do të sillnin këtu dy vëniet në skenë të komedisë së Kristo Floqit “Zi e ma Zi”, në konceptime regjisoriale krejt te ndryshme, nga Teatri i Gjirokastrës , si komedi realiste, me kolorit të theksuar krahnior e karakter original dhe ajo e Teatrit “Skampa” të Ebananit, në trajtën e një vodevili gazmor. Ja sesi teatri , me krijimet e veta , mund të gjëjë e shprehë spektakle të ndryshme të së njëjtës vepër. Kësisoj, bëhet ajo që kerkohet shpesh, eksperimentimi i llojeve të shumta që ekzistojnë në teatër e që duhet ta kryej cdo teatër ne punën e vet krijuese, pa qenë nevojia fare te ekzistoj një “Teatër Eksperimental” me vete!

Potencia e këtij festivali ndjehet edhe nga debutimi aty e disa artistëve të formuar si personalitete në artin e tyre, si aktorja argjentinase Griselda Gambaro, rumuni Caltalin Mirea, trioja aktorese malazeze Malinovska, Babović e Pejović, aktori shqiptaro-maqedonas Bajrush Mjaku e ajo shqiptare Klodjana Keço, fisarmoniçti shqiptar Elton Balla dhe e një trupe baleti nga Prishtina, që sollën aty “Xhuljata pa Romeon”, një version të subjektit shekspjarian të zhvendosur në kohën e dhunës serbe në Kosovë. Po, për fat të keq, do të ndjehej aty edhe më-naxhimi i dobët i organizatorëve vendas, në një kohë kur këto trupa të ardhura nga “ana e anes” dhe personaliteteve te artit u duhej te interpretonin para një salle edhe me 20 vetë! Nuk ka mjerim më të madh për artistët e përkushtuar! Pa përmëndur këtu faktin evident që nuk të “zinte syri” as pushtetar vendor, ministrot e deputetë të partive politike, që kanë doemos “ethe te tjer”, jashtë eventeve të tilla, qofshin edhe “nderkombtare”!

FJALËKRYQESH

NGA **KADRI VOKOPOLA**



FJALËKRYQI PA SKEMË

DUHET TË NXINI **37** KUTI

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17
1																	
2																	
3																	
4																	
5																	
6																	
7																	
8																	
9																	
10																	
11																	
12																	

HORIZONTAL

- Kryeqëzori që goditi Pallatin e Dimrit.
-Balsam që që aktor.
- Eshtë copë për qermer.
-Inicialet e Daudet
-Janë vendet e podiumit.
- Qe mbretëreshë e frankëve.
-Stiller aktor.
-Noide piktor.
- Emerson Lake & Palmer.
-Lumë në Rusi.
-Janë njëkësi e Sal Berishës.
- Ka rivalë Mediaset.
-Unë dhe ti.
-Një ... art i Don Judd
-Të parat më ambion.
- Konak pa kufji.
-Eshtë arti japonez i zbukurimit me letra.
-Fillojnë latsëgjatën
- Ishin këngët si carmina burana.
- Provuar me aparaturo.
-Agamia pa çifte
-Pak kilometra.
- Libhova këngëtare.
-Emri i Due Shkripes.
-Jorge shkrimtar.
- Mund të jetë me sahat.
-Agjenti i James Coburn.
-Janë të shumtë në kor.
- Eshtë transmetimi live.
-Lumë në Afrikë

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT PA SKEMË

M	A	T	I	N	E	S	Z	K	A	M	M	E		
I	V	K	R	U	S	H	K	A	A	M	A	N	E	T
T	A	K	I	M	I	K	A	N	I	B	A	L	I	I
E	R	E	N	A	M	A	R	O	N	I	T	E	T	M
T	I	N	A	F	A	T	O	R	I	N	O	T	K	O
T	I	K	A	F	E	N	E	A	R	R	E	L		
S	E	P	F	L	I	R	T	J	T	P	O	L	O	
P	A	T	A	L	A	R	I	K	U	R	O	D	G	
I	N	H	X	I	K	L	I	R	I	J				
T	D	V	S	H	I	M	I	I	N	A	T	S	I	
A	R	I	E	O	F	E	N	D	U	E	S	E	A	K
L	E	T	R	A	R	T	A	K	S	A	R	E	N	E

- Mbyllin porte.
-Gjysma e Jetrir
- Nuki i tregohet babait.
- Fillojnë aksionin.
- Rainer Maria poet
- Gjysma e garave
-Kufizojnë një teknik.
- Fillojnë dashurinë.
-I keni në dorë.
- Dy asa.
-Pak molepsje.
-Një rruzull i Tokës.
- Inicialet e Duras.
-Eshtë mëkat kapital.
- Kurbat pa kub.
-Janë strehë për barinj.
- Gjiganti që u pika nga akrepi.
- Fillojnë temën.
- Mbyllin arkivin.
-Janë talentatell velletrasës.
- Andrea aktore
-Ishte Porta e Sulltanit.
- Ndizen me një qelës.
-E ka motër mamanë
- Të le në mëdyshe
-Taulanti kërkon një...

FJALËKRYQI SPORTIV

	1	2	3	4	5	6	7	8	9
1									
2									
3									
4									
5									
6									
7									
8									
9									
10									
11									
12									

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT SPORTIV

S	R	J	A	R	A	R	T	A	S						
Y	O	K	O	M	I	L	A	N	R	O	M	A			
M	A	R	T	I	N	D	E	R	E	K					
H	A	M	D	I	S	A	L	I	H	I	R	T			
N	O	V	A	R	I	A	N	T	I	C	I	C	D	I	E
O	L	E	R	I	O	N	E	O	R	O	L				
T	A	U	S	K	A	I	R	I	T	E	A	M			
R	E	A	L	U	O	P	O	R	T	A					
I	L	M	I	R	E	L	J	O	S	A	N				

HORIZONTAL

- Fagu ish-futbollist.
- Një i thyer në strofë.
- Janë në dorë.
- Kush e thotë lutet.
- Ai i rekordeve është Guinness
- Bonucci te Juventus.
- Eshtë e zakonshme për pushime.
- Një skuadër e Lisbonës.
- Lejon me një jo.
- Fillojnë pushimet.
- Qe kampion i boksit.
- Takohen në kufij.
- I keni në dorë

- Eshtë luftarak me kung fu.
- Ekstre në Oslo.
- Irlanda në Dublin.
- As unë as ti.
- Memoria në computer
- Kënga pa çifte.
- Janë një me bisht.
- Personazhi në foto.
- Duken të gjata në pritje.
- Personazhi në foto.

VERTIKAL

- Një luhet në skenë.
- Oyteni që thirret Leonessa d'Italia.
- Ermi i Gabbiadini-t.
- Kështu mund të jetë një guatje denimi.
- Një pjesë e lillputëve
- Ferrara regjisor
- Tundel nga ... golat.
- De Biasi në stolin kuqez.
- Verratti mesfushor.
- Duan talent të tilla.
- Një pjesë e operacioneve.
- Janë notare për Italianet.
- Errant tenite.
- Fitohe nga të parët.
- Ka vijën fatale
- Lidh brinjë
- Fillojnë matanë.
- Mbyllin një raport.
- Fillojnë nesër.
- Kihente në ar do gjë që prekte.
- Parashitja e muskullit.
- Teke klasë.
- Një fjalë parandaluese
- Janë në verë
- Ekstre në ndikim
- Inicialet e Reisman
- Louise Colet
- Ekstre në litar.

SUDOKU

PLOTËSONI VENDET BOSH NË MËNYRË QË ÇDO RRESHT E KOLONË TË KETË NUMRAT NGA 1-9

7	5	6	4	1	3	9	2	8
1	9	3	2	5	8	4	7	6
2	8	4	7	9	6	5	1	3
5	1	9	8	6	2	3	4	7
3	4	2	9	7	5	6	8	1
6	7	8	1	3	4	2	5	9
9	2	7	3	4	1	8	6	5
8	6	1	5	2	9	7	3	4
4	3	5	6	8	7	1	9	2

1		2		7				5
	7		4					9
		8	9	5	3			
6	9	7	5	2	4			3
	8		6		9		5	
7		5	4	3	8	1		9
		1	8		4	7		
	6			7			1	
4			1		6			8

HOROSKOPI

DASHI

Komunikimi me partnerin nuk do jete aspak i mire gjate kësaj dite. Mund te keni here pas here mosmarrveshje dhe probleme te forta me partnerin dhe ndonjherë mund te mendoni edhe t'i jepni fund gjithçkaje. Beqaret do fillojnë aventura te këndshme te cilat do t'imbushin me gëzim. Buxhetin duhet ta menaxhoni ne një tjetër mënyrë nëse nuk doni te keni probleme.

LUANI

Dite e veçantë do jete kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Nuk do merrnit vesh për mrekulli me partnerin tuaj, do argëtoheni dhe do qeshni pafund. Beqaret do e lënë pas turpin dhe do e joshin gjithë kohës personet qe pëlqëjnë. Për ta mund te filloje një periudhe fantastike. Ne planin financiar do ju ndihmojnë gjithë kohës familaret dhe nuk do keni probleme.

SHIGJETARI

Dite tejet pozitive do jete kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Do merrni vesh për mrekulli me partnerin tuaj, do argëtoheni dhe do qeshni pafund. Beqaret do e lënë pas turpin dhe do e joshin gjithë kohës personet qe pëlqëjnë. Për ta mund te filloje një periudhe fantastike. Ne planin financiar do ju ndihmojnë gjithë kohës familaret dhe nuk do keni probleme.

DEMI

Dite mjaft harmonike do jete kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Pasioni gjithashtu do shtohet dhe kënaqësitë do jene te njëpasnjëshme. Beqaret me ne fund do arrijnë ta bëjnë për vete personet qe kane pëlqyer prej kohesh dhe do fillojnë menjherë një lidhje. Ne planin financiar duhet vetëm te jeni pak me te kujdesshëm me shpenzimet dhe gjendja nuk do ketë probleme.

VIRGJËRESHA

Mos flisni e kërcënoni partnerin me ndarje sot nëse nuk ua plotësoni dëshirat sepse do e përkeqësoni edhe me shume situatën ne te cilën ndodheni. Me mire reflektoni ne qetësi para se te flisni. Beqaret do kenë disa ditë mjaft te ngrohte dhe e përgjithmonë. Ne mbrëmje mund te takojnë edhe persona interesante. Financat do vazhdojnë te jene te qëndrueshme dhe aspak problematike.

BRICJAPI

Dite e qëndrueshme dhe pa asnjë problem do jete kjo e sotmja për te dashuruarit. Nuk do keni asgjë për çfarë te qeshni, thjesht do shfrytëzoni momentet e këndshme. Beqaret do kenë disa takime te papritura te cilat mund t'ua ndryshojnë jetën njëherë e përgjithmonë. Ne planin financiar do jeni me shume fat. Gjendja do jete e shkëlqyer dhe pa asnjë lloj problemi.

BINJAKËT

Venusi do ju beje me sharmant sot ju te dashuruarit dhe marrëdhënia me partnerin ka për te qene tejet e veqante. Ne orët e pasdites dhe mbrëmjes mund te përgatitni edhe surpriza për njeri-tjetrin. Beqaret do vazhdojnë te jene ne kërkim te princit te kaltër, por pa rezultat. Ne planin financiar nuk duhet t'i besoni vetëm instinktit tuaj sepse mund te bëni gabime.

PESHORJA

Dite mjaft e favorshme do jete kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Komunikimi dhe bashkëpunimi mes jush do jete për t'u pasur zili. Beqaret nuk do duan ende te bëjnë ndryshime te statusit te tyre dhe do vazhdojnë te mbeten vetëm. Ne planin financiar do keni me shume vështirësi se me pare kështu qe duhet te tregoheni sa me te matur dhe sa me te kujdesshëm.

UJORI

Dite e mbushur me probleme do jete kjo e sotmja për te dashuruarit. Do jeni te dy palët kokëfortë dhe nuk do t'i pranonin gabimet qe keni bere. Beqaret duhet te jene me te hapur ndaj takimeve sepse mundësitë do do ju luptojnë sot do jene vërtet interesante. Buxhetin do e mbanin gjithë kohës nen kujdes dhe gjendja nuk do ketë aspak probleme. Mund te bëni edhe ndonjë investim.

GAFORRJA

Sot do afroheni akoma me shume me partnerin tuaj ju te dashuruarit dhe marrëdhënia me çift do jete e shkëlqyer. Te gjithë do ju kenë zili. Beqaret duhet t'ia lënë çdo gjë ne dorë kohës dhe nuk duhet te kërkojnë dicka me ngulm. Sot me mire t'i marrin gjerat shtruar. Financat nuk do keni aspak probleme kështu qe mund t'i kryeni pa frike shpenzimet e menduara.

AKREPI

Dite ju shume e qëndrueshme do jete kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Here pas here mund te keni edhe debate te forta me njeri-tjetrin dhe do e ngriini zërin. Për beqaret ndikimi i yjeve do jete mjaft pozitiv. Kjo do jete një dite e jashtëzakonshme dhe e mbushur me takime fantastike. Ne planin financiar nuk do bëni aspak gabime dhe gjendja do mbetet e kënaqshme.

PESHQIT

Pasioni do shtohet fuqishëm sot ne jetën tuaj ne çift dhe kënaqësitë do jene te njëpasnjëshme. As vete nuk do e besoni dot se jeni ne realitet dhe jo ne ëndërr. Beqaret do jene gati edhe për aventura kalimtare vetëm qe te mos mbeten me vetëm. Financat do jene te njëjta. Mundohuni te paktën te shpenzoni me sa me shume maturi qe gjendja te mos tronditet.

PËRGJIGJE

P	O	R	E	K	A	N	S	K	I
M	A	R	K	K	G	I	A	N	A
O	D	A	D	O	K	M	E	N	T
N	I	R	E	P	A	R	I	T	E
O	K	O	M	E	N	T	E	T	A
P	R	E	D	I	K	U	E	S	A
O	D	I	M	E	N	S	I	O	N
I	D	O	T	I	T	A	K	A	K
F	R	E	O	T	M	E	Z	I	T
T	E	K	R	E	D	I	E	M	A
K	A	P	E	L	E	S	T	I	E
G	A	G	A	P	O	Z	A	T	D

SHKRONJA ENJËTË PËR NUMËR TË NJËTË

FJALËKRYQI I KRIPTOGRAFUAR

4	M	3	A	9	N	I		10	8	4		2	3	7
3		8			2	3	10	5	9	7	10	1		3
			2	1	7	6	11	3	7	8	11	3		
5		1	11		4	3	9	5	9			12	3	
8	9	13	6	11		2	1	2	3			4	10	
2	3	16			12	1	4	5	7	11	3	7		
1	4	5	11	3	2		6	14	3			11	6	
3		11	5		3	4		15		16	3			
9		6	4		2	8	14	1	9	3		4		
	6		3	4	5		3	10	8	2	2	1		
1	7		10	3	4	3	7	6		2	6	10		
4	3	9	6	7		2	1		4	1	10	6		

Dueli



Manchester City -Chelsea, një nga ato duele që mund të të ndryshojë rrjedhën e sezonit dhe kështu mund të rezultojë për skuadrën e Antonio Contes që vazhdon të thyejë çdo kundërshtar që i del në rrugën drejt titullit. Fitorja e tetë rresht për "Blutë e Londrës" vjen pas një 90 minutëshi të çmendur në Manchester ku cinizmi i italianit triumfoi ndaj futbollit total të Guardiols, skuadra e të cilit shpërdoroi deri në abuzim. 3-1 triumfuan londinezët në duelin e kreu duke kthyer në favorin e tyre disavantazhin e pjesës së parë dhe duke e çuar në +4 diferencën me "Citizens".

Skuadrat të kujdesshme nuk dhanë pika referimi në minutat e para por në të 15-ën ishte Hazard që lëshoi një goditje të fortë duke drithëruar të pranishmit në "Etihad Stadium", 6 minuta më vonë ishte radha e Kun Agueros i cili u ndal nga Thibaut Courtois me një pritje spektakolare. Goli i parë u shënuar nga Fernando, por sa keq që ajo rrjetë e brazilianit ishte në pozicion të parregullt, ndërsa Aguro shpërdoroi një rast të artë që ilustron mungesën e qetësisë së "Citizens" përpara portës. Armata e Pep Guardiols u bë më kërcënuese me kalimin e minutave duke rrezikuar sërish me argentinasiin që pas asistit të marrë nga De Bruyne nuk arriti të shënjestronte saktësisht. Sa shumë raste të shpërdoruara nga Manchester City, por çfarë gare ajo e Gary Cahill në fundin e pjesës së parë. Mbrojtësi i Chelsea



Chelsea fiton super-duelin e Anglisë me Manchester City

Pragmatizmi i Contes ka triumfuar ndaj spektaklit të Guardiols

3-1 triumfuan londinezët në duelin e kreu duke kthyer në favorin e tyre disavantazhin e pjesës së parë dhe duke e çuar në +4 diferencën me "Citizens"

me një devijim të pafat u dhuroi bardhekaltërve avantazhin. Pushimi i pjesës së parë nuk i ftoh gjakrat sepse City kërkoi golin e dytë që në të 48-ën kur De Bruyne nuk u tregua aspak altruist duke

shpërdoruar një tjetër rast. 5 minuta më vonë Aguro ia ktheu me të njëjtën resto belgut duke zgjedhur goditjen personale që u ndal sërish nga Courtois . Momenti kulminant i monologut të "citizens" me portën e bluve kulmoi me transversën e De Bruyne (57), i cili bëri më të vështirën duke mos e shtyrë topin në rrjetë dhe ky ishte momenti që shkatërroi ëndrrat e skuadrës së Pep Guardiols. Chelsea fitoi oksigjen dhe si një skuadër eksperte e thumbi kundërshtarin në dy raste, fillimisht me Diego

Costën që ngriu vendasit me golin e barazimit. Goli i dytë është një manual për futbollin e Antonio Conte, dy pasime dhe Ëillian i vetëm përballë Bravos tregohet i pamëshirshëm. Çfarë dueli, Manchester City nuk arrin të kuptojë absurdin e një momenti të tillë, ndërsa "Blutë" me eksperiencë ndërtojnë një tjetër gol fotokopie me të dytin në minutën e fundit të takimit. Një 3 pikësh ky që e konfirmon Chelsean forcën kryesore dhe rivalin për t'u mundur nga të gjithë në Premier League.

SERIE A/ JUVE ME MUNGESA NË MBROJTJE

Rikthehet Juventus, gjunjëzon Atalantën

Mungesat në mbrojtje janë problemi i madh i Juventusit këto kohë por pikërisht mbrojtësit ishin ata që i dhanë fitoren ekipit torinez ndaj Atalantës, me Alex Sandron dhe Ruganin që shënuan të dy në suksesin e bardhezinjve në shtëpi. Skuadra e Allegrit bëri menjëherë autokritikë, pas asaj humbje javën e kaluar nga Genoa duke mundur 3-1 ekipin e momentit në Serie A, me Atalantën që vinte pas 6 fitoreve radhazi në kampionat. Me Berishën, jashtë për shkak të një dëmtimi, zikalitërit aktivizojnë nga minuta e parë sërish Sportiellon. Juventus pati meritën se goditi mjaft shpejt duke mbyllur ndeshjen në vetëm 4 minuta. Alex Sandro ishte ai

që nisi serinë e golave pas një "vallëzimi" spektakolar mes mbrojtjes bergamaske në të 15-tën. Në të 19-tën ndeshja ishte praktikisht e mbyllur me mbrojtësin tjetër Rugani që realizoi me kokë pas një harkimi në zone nga Pjanic. Gjithsesi festa e Juventusit nuk përfundoi me kaq, pasi në pjesën e dytë Mandzukic rregulloi bilancin e sulmuesve duke shënuar dhe golin e 3-0. Në fund Atalanta arriti të shkurttojë diferencën me Freuler, një gol që vlen vetëm për statistika sepse pikët në fund i mori Juventus që vazhdon të ketë diferencë me ndjekësit. Mario mandzukic ishte padyshim lojtari më i mirë në fushë jo vetëm për golin por për një lojë pozitive në të gjithë fushën nga sulmi e deri në mbrojtje.



Në fokusin e lexuesit online



LAJMET MË TË LEXUARA DJE

- Shuhet analisti Andrea Stefani vuanë nga një sëmundje e rëndë
- Foto/Miku i 'të fortit' të Tiranës terrorizoi qytetarët në Tiranë
- "Polic"i Portokallisë bëhet baba për herë të dytë, ja emri i djalit
- I dënuri përjetë, gruaja braktis "Gaxhain", divorc në gjykatë
- Studentja fle, harron provimin Përgjimet:Jepi 'veglat' pedagogëve
- Amnistia,zbrazen burgjet,kush lirohet e kujt i pushohet hetimi
- Bes Kallaku ironizon Ermalin:Po unë që kam fjetur me gjyshen deri 23 vjeç
- Baze: Çastet e fundit të Andreas i bindur se do e fitonte këtë betejë
- Blushi tradhton transparencën regjistrohet si kryetar partie
- Zhdukja e Remzi Hoxhës, Ilir Kumburo jeton në Cardiff?

LAJMET MË TË KOMENTUARA

- Shuhet analisti Andrea Stefani vuanë nga një sëmundje e rëndë
- Himarë, ngrihet flamur grek në avllinë e shtëpisë
- Eurodeputetja qipriote në Tiranë:Gjendem mes Vorioepirit
- Dhunoj policët, në pranga vllai i kryetarit të Bashkisë së Devollit
- Deklarata e deputetes së Qipros Dule:Sinkron në raportet me Greqinë

VIDEOT MË TË KLIKUARA DJE

Moti për datën 03/12/2016 dhe ditët në vazhdim

60 minuta në Prokurori, Briseida Shehaj në dalje: Gëzuar Festat!


Fatos Klosi: Ku gënjen Berisha për zhdukjen e Remzi Hoxhës

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas

SONDAZHI I DITES

Sipas eksperiencës tuaj, rastet e ndërprerjes së energjisë elektrike janë:

Rezultati i Sondazhit



SHËNIM:

Sondazhet online të Shqiptarja.com, nuk kanë vlerë statistikore. Bëhet fjalë për pyetje që u bëhen të gjithëve dhe jo kampionëve të përpunuar në mënyrë shkencore. Pra, kanë si qëllim të vetëm të lejojnë lexuesit të shprehin mendimin e tyre rreth temave të aktualitetit. Megjithatë, çdo lexues, mund të votojë vetëm një herë në ditë



1.843 KOMENTET E DJESHME | 316.607 TOTALI LIKE